


PLATFORMA "LearnIn" PËR TË NXËNIT GJATË EMERGJENCAVE MANUAL I MËSUESIT



Ky manual u hartua në kuadër të projektit “LearnIn, shaping the culture of education”. Projekti është një Nismë e UNICEF-it në Partneritet me Universitetin e Edukimit në Zyrih. Ai është krijuar për të fuqizuar mësuesit përmes krijimit të mundësive të mësimdhënies me cilësi të lartë gjatë zhvillimit të mësimin në distancë dhe/ose të përzier, si dhe t'i mbështesë ata në krijimin e mësimdhënies së personalizuar për të gjithë nxënësit.

Ky projekt u mundësua nëpërmjet kontributit të Qeverisë Holandeze në Shqipëri, SDG Acceleration Fund.

Manuali u bë i mundur me mbështetjen e zyrës së Unicef në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar.

Autor: Judith Hollenweger Haskell (JHO) - Universiteti i Edukimit të Mësuesve në Zurich – Zvicër

Përshtati dhe redaktoi: Albana Markja, Evis Mastori dhe Aurela Zisi

*Publikoi: Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, ASCAP.
Nëntor 2020*

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	4
MODELI REFERENCË I PLATFORMËS "LEARNIN"	5
Vështrim i përgjithshëm	5
Koncepti i “të Nxënit” si Veprimtari.....	6
Koncepti i “Agjentit/Personit(ave) Veprues” - Kush?	7
Koncepti i “Zotësisë” - Për çfarë?	8
Koncepti i “Njohurive të disiplinës” - Çfarë?	10
Koncepti i “Kontekstit” - Ku?	11
Koncepti i “Mjeteve” - Si?	13
PJESA 1: MBËSHTETJA E NXËNËSVE GJATË IZOLIMIT NË SHETËPI.....	15
Si të mbështesim nxënësit në shtëpi: Analiza e situatës.....	15
Si të mbështesim nxënësit në shtëpi: Çështjet dhe pyetjet kyçe.....	16
Si të kuptojmë situatën e nxënësve jashtë shkollës duke u përqendruar te nxënësit (kush?).....	16
Si të identifikojmë qëllime kuptimplota për të nxënit në shtëpi duke u përqendruar në qëllimin e të nxënit (pse?)	18
Si të zgjedhim njohuritë përkatëse ose kompetencat e disiplinës duke u përqendruar te procesi i të nxënit (çfarë?)	20
Përfitimet nga mjediset mësimore në shtëpi – Të përqendrohemi në kontekstin e të nxënit (ku?)	22
Përdorimi i mjeteve dhe strategjive për të mbështetur nxënësit në distancë – Të përqendrohemi te mjetet mësimore (Si?).....	24
PJESA 2: MIRËPRITJA E NXËNËSVE SËRISH NË SHKOLLË	27
Mirëpritja e nxënësve sërish në shkollë: Analiza e situatës	27
Mirëpritja e nxënësve sërish në shkollë: Çështjet dhe pyetjet kyçe	28
Të kuptojmë situatën e nxënësve jashtë shkollës duke u përqendruar te nxënësit (KUSH?)	28
Sigurimi i pjesëmarrjes së nxënësve që kthehen në shkollë duke u përqendruar në qëllimin e të nxënit (PSE)?.....	31
Përdorimi i përvojave të nxënësve si pikë fillestare për të nxënit duke u përqendruar te të nxënit (ÇFARË?)	33
Kalimi nga mjediset e shtëpisë në ato të shkollës duke u përqendruar të konteksti mësimor (KU?).....	36
Mjetet dhe strategjitë për të filluar të nxënit në shkollë duke u përqendruar te mjetet mësimore (si?)	38

PJESA 3: KRIJIMI I MËNYRAVE TË PERSONALIZUARA TË TË NXËNIT PËR NXËNËSIT	42
Krijimi i mënyrave të personalizuara të të nxënit për nxënësit: Analiza e situatës	42
Krijimi i mënyrave të personalizuara të të nxënit për nxënësit: Çështjet dhe pyetjet kyçe	44
Të kuptojmë situatën e të nxënit të nxënësit duke u përqendruar te nxënësi (Kush?)	44
Vendosja e qëllimeve me vizionin e zgjerimit të aftësive duke u përqendruar në qëllimin e të nxënit (Pse?).....	46
Zhvillimi i një kurrikule të bazuar te nxënësit duke u përqendruar te të nxënit (Çfarë?).....	48
Krijimi i mjediseve të personalizuara mësimore duke u bazuar në kontekstin mësimor (Ku?)	51
Mjete dhe strategji për të mbështetur të gjithë nxënësit duke u mbështetur te mjetet mësimore (Si?).....	53

HYRJE

Besimi se çdo fëmijë ka të drejtë për arsimim dhe mundësi për mësim cilësor janë në thelb të qasjes së të drejtave të njeriut të MASR, ASCAP dhe UNICEF ndaj arsimit. Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (CRC) dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD), të dy shprehin qartë qëllimin e garantimit të arsimit cilësor për të gjithë dhe rëndësinë e ofrimit të mbështetjes së kërkuar holistike për zhvillimin e potencialit të secilit fëmijë. Edukimi cilësor mund të arrihet vetëm kur secili dhe çdo fëmijë, përfshirë më të marginalizuarit dhe të përjashtuarit, janë në shkollë duke marrë edukim cilësor gjithëpërfshirës që u siguron atyre aftësimin e kërkuar për jetën.

Në kushtet e ndërprerjes së mësimin, për shkak të pandemisë Covid19 si dhe pas tërmetit të Nëntorit 2019, përpjekjet për të vazhduar më tej e kanë vendosur fokusin në përmirësimin e rezultateve të nxënësve dhe zhvillimin e aftësive të tyre, duke përmirësuar kompetencat e mësuesve në arsimin cilësor gjithëpërfshirës. Për ta arritur këtë, UNICEF, në partneritet me Universitetin e formimit të mësuesve në Zyrin, filluan LearnIn - një iniciativë e të mësuarit digjital, e dizajnuar për të mbështetur si mësuesit ashtu edhe nxënësit si nxënës gjatë gjithë jetës. LearnIn do të sigurojë mundësi të nxëni cilësore, të personalizuar dhe kulturore, brenda një mjedisi digjital, duke nxitur bashkëpunimin dhe shkëmbimin e eksperiencave.

Edhe Shqipëria u përfshi në këtë nismë që në fillimet e saj. Zyra e Unicef në Shqipëri në bashkëpunim me MASR dhe Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar – ASCAP bashkëpunuan për të gjetur strategjinë e përshtatshme dhe efektive në përcjelljen dhe zbatimin e kësaj nismë në sa më shumë institucione arsimore në arsimin e detyruar dhe tek sa më shumë mësues në sistemin arsimor.

MODELI REFERENCË I PLATFORMËS "LEARNIN"

Vështrim i përgjithshëm

Modeli i platformës "LearnIn" ofron një kornizë për të kuptuar marrëdhëniet më të rëndësishme ndërmjet personit(ave) veprues, veprimtarive, sistemeve dhe proceseve që kanë të bëjnë me mbështetjen e të nxënës në një mjedis të caktuar. Ky material synon të paraqesë një kuptim të përgjithshëm të koncepteve kyçe dhe të lehtësojë komunikimin, të nxënës dhe gjetjen e zgjidhjeve në kushte të ndryshme. Modeli i referencës ofron një shpjegim për personat jospécialistë mbi kornizën konceptuale në të cilën mbështetet materiali. Ai promovon kuptueshmërinë e një sërë problemesh që lidhen me gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme, por nuk përcakton një zgjidhje të posaçme për këto probleme. Modeli i referencës i platformës "LearnIn" është mjaftueshëm fleksibël për t'u zbatuar në mjedise të ndryshme dhe nuk mbështetet në teknologjinë apo platforma të ndryshme. Pjesa më e madhe e koncepteve kyçe që janë përdorur në modelin e referencës së platformës "LearnIn" nuk janë të reja, pasi janë përdorur më parë në Modulet e UNICEF "Trajnimi i Trajnuesve" mbi Arsimin Gjithëpërfshirës.


Zhvillimi i arsimit në kohën e COVID-19 apo emergjencave të tjera të ngjashme, kërkon: (1) një përgjigje të koordinuar me fokus te lehtësimi i veprimeve, për të siguruar që nevojat e të gjithë personave të prekur të adresohen; dhe (2) veprime të menjëhershme nga ana e mësuesve, edhe nëse sistemet arsimore nuk janë ende të përgatitura. Autoritetet (MASR si autoriteti përfaqësues) krijojnë kushtet, ofrojnë, organizojnë dhe mbikëqyrin arsimin; dhe brenda kësaj kornize kryhet puna e përditshme nga shkollat dhe mësuesit. Në kohë krize, qeveritë mund të mos jenë në gjendje të sigurojnë funksionimin e shkollave, ose vendosin qëllimisht që të mos e bëjnë këtë. Synimi i këtij materiali është të ndihmojë secilin mësues, si dhe grupet e mësuesve, që të mund të punojnë me nxënësit e tyre dhe prindërit pa pasur nevojën të presin për një zhvillim të koordinuar apo për një sistem arsimor alternativ digjital apo të barasvlershëm që nuk mbështetet tek prania dhe kontakti fizik. Është e nevojshme që mësuesit të nxiten që të fillojnë mësimdhënien sa më parë të jetë e mundur, por duke marrë në konsideratë koordinimin dhe sinkronizimin e praktikave të reja në një moment të dytë.

Manuali ofron mbështetje për planifikimin, zbatimin dhe reflektimin mbi veprimet e mësuesve që lidhen me situata specifike gjatë krizës së COVID-19, dhe është konceptuar për të adresuar problematikat që do të vijnë pas krizës. Ai mbështetet mbi një kornizë të përbashkët për të mundësuar transformimin e njohurive të përfshira këtu në veprimtari për kontekste dhe situata të ndryshme. Ky manual ofron një përmbledhje të pikave kyçe që do të zbatohen duke u bazuar në përvojat në vende të ndryshme.

Konceptet dhe organizimi i informacionit që janë përdorur në këtë manual janë të harmonizuara me Modulet e UNICEF "Trajnimi i Trajnuesve" mbi Arsimin Gjithëpërfshirës.

Koncepti i “të Nxënit” si Veprimtari

Të nxënit mund të kuptohet si një veprimtari: Një person(a) veprues (“KUSH”) përfshihet në një fushë njohurish / lënde (“ÇFARË”), për të kontribuar në zotësinë e tyre (“PËR ÇFARË”) për të vepruar me sukses në një kontekst të caktuar (“KU”), duke përdorur mënyrat më efikase mendore, fizike ose teknologjike (“SI”).



Të nxënit ndodh kur veprimtaria përfundon me transformimin e një personi(ave) veprues (për shembull, ndjesia e identitetit, besimet, qëndrimet), e njohurive të disiplinës/lëndës (për shembull, të kuptuarit të problemeve, njohuritë konceptuale, etj.), e kontekstit (aftësisë për të luajtur rol në kontekste të ndryshme shoqërore dhe fizike), ose e mjeteve (për shembull, aftësitë për zgjidhjen e problemeve, strategjitë e të nxënit, modelet mendore). Ky transformim duhet të ketë si synim përmirësimin e aftësive të personit(ave) veprues për të zgjidhur problemet në jetën e përditshme, për një jete më të kënaqshme, më të përgjegjshme dhe më të fuqizuar.

Përgjithësisht, iu kushtohet shumë vëmendje “njohurive të lëndës” (elementët e përmbajtjes së një kurrikule, lëndë si matematika, tematikës ose temës) dhe mjeteve (fletët e punës për të shkruar, librat, mënyrat digjitale të të nxënit). Megjithatë, nëse njohuritë e lëndës dhe mjetet e propozuara nuk janë të bashkërenduara me personin(at) veprues (mësuesit, trajnuesit, prindërit) me qëllim arritjen e objektivave afatgjata të të nxënit, si dhe me mjedisin ose kontekstin përkatës shoqëror dhe fizik, janë të pakta gjasat që të nxënit të çojë drejt një transformimi të qëndrueshëm të sjelljeve, aftësive dhe kompetencave, dhe aq më pak të zotësisë së personit(ave) veprues.

Në këtë Manual, fokusi kryesor është te të nxënit, jo te njohuritë e lëndës apo mjetet. “E drejta për Arsim” kuptohet si “E drejta për të nxënë”, pavarësisht arsimimit formal. Manuali iu drejtohet mësuesve, qofshin ata me përvojë formale ose joformale në mësimdhënie, shumë të kualifikuar apo pa kualifikime. Tri pjesët e këtij Manuali adresojnë tri fazat e krizës së arsimit të shkaktuar nga COVID-19. Secila nga pjesët është strukturuar në të njëjtën mënyrë: (1) “Analizë e Situatës” për të arritur në një

kuptim të përbashkët, (2) “Problematikat dhe pyetjet kyçe” që duhet të kuptohen dhe adresohen, dhe (3) “Reagimi ndaj sfidave” për të zhvilluar praktika të mira për adresimin e problematikave kyçe.

Platforma "LearnIn" i angazhon mësuesit si nxënës për t'i pajisur me njohuri të zbatueshme. Termi njohuri të zbatueshme nënkupton që mësuesit janë të aftë që të përdorin drejtpërdrejt atë që mësojnë në mënyrë që të ndihmojnë për zgjidhjen e problemeve “të jetës reale”. Ne jemi të vetëdijshëm që mësuesit mund të kenë pikëpamje të ndryshme mbi çfarë është “të nxënit” dhe mund të mos kenë dijeni për konceptet e “nxënësve aktive” apo qasjeve “konstruktiviste” ndaj të nxënit. Ne po punojmë me metaforat e mëposhtme të të nxënit për të qartësuar këtë problematikë: (1) Të nxënit si përvetësim i njohurive (vëmendja te ÇFARË dhe SI), (2) Të nxënit si ndarje njohurish (vëmendja te ÇFARË dhe KU), dhe (3) Të nxënit si krijim i njohurive (vëmendja te ÇFARË dhe PËR ÇFARË).

Koncepti i “Agjentit/Personit(ave) Veprues” - Kush?

Pedagogjia e Platformës "LearnIn" përqendrohet te të nxënit si një veprimtari dhe, si rrjedhojë, e konsideron nxënësin si një agjent aktiv/person veprues. Agjenti është një person që nxë, dhe ky term mund t'iu referohet dhe një grupi personash. Të nxënit kuptimplotë adreson nevojat e nxënësit, dhe merr në konsideratë përvojat, aftësitë dhe interesat e tyre. Nxënësit duhet të fitojnë akses në njohuri, të marrin pjesë në proceset e ndarjes së njohurive dhe të realizojnë një transformim të zotësive në të nxënë (akses, pjesëmarrje dhe arritje), në mënyrë që të mund t'i shfrytëzojnë këto aftësi për të nxënit gjatë gjithë jetës. Megjithatë qëllimi kryesor i Platformës "LearnIn" është përmirësimi i të nxënit për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, vëmendja parësore është te promovimi i kapaciteteve të mësuesve për të nisur, për të drejtuar dhe vlerësuar të nxënit tek të gjithë nxënësit.

Mësuesit janë agjentët/personat kryesorë që bëjnë të mundur lehtësimin e të nxënit për fëmijët në kushtet e arsimit formal, si në shkollat publike. Termi “edukator” përdoret për t'iu referuar çdo personi që ka “rol mësimdhënës” ose çdo personi të caktuar për të mbështetur apo që dëshiron të mbështesë të nxënit për fëmijët dhe të rinjtë, me ose pa trajnim formal. Ky term përdoret dhe për prindërit ose kujdestarët që kanë ndikim në zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve. Agjentët që punojnë në Ministri, Universitete ose OJQ kanë një ndikim të tërthortë në të nxënit e fëmijëve, për shembull nëpërmjet hartimit të kurrikulave të reja, përfshirjes së skemave të testimit kombëtar ose nëpërmjet financimit të veprimtarive për rritjen e kapaciteteve të mësuesve.

Zakonisht, mësuesit e konsiderojnë veten si agjentë të pavarur me autonomi të konsiderueshme, të paktën për sa i përket klasës së tyre. Në shumë vende, mësuesit punojnë të izoluar dhe nuk janë të mësuar me përdorimin e praktikave bashkëpunuese

në klasë, marrjes së përshtypjeve nga kolegët apo angazhimin në veprimtari që përmirësojnë punën në ekip. Një sistem shkollor me një qasje tradicionale nga lart poshtë për zbatimin e reformave mund të shkaktojë mohimin e të drejtave të mësuesve, dhe si rrjedhojë edhe të nxënësve. Vetëm mësuesit që kanë ndjesinë e efikasitetit vetjak ose kolektiv janë në gjendje të hulumtojnë qasje dhe praktika të reja dhe të bëhen agjentë të ndryshimit.

Adresimi i efektshëm i problematikave të tilla, si luftimi i përjashtimit apo arritja e barazisë së mundësive për të gjithë fëmijët në një komunitet, kërkon bashkëpunim të ngushtë dhe veprime të koordinuara të palëve të ndryshme të interesit në një sërë organizatash dhe sektorësh (për shembull, të shëndetësisë, arsimit, dhe social). Ekipet, grupet e punës ose komunitetet profesionale duhet të arrijnë efikasitet vetjak kolektiv, dhe jo të mbeten vetëm zbatues pasivë të politikave, rregulloreve dhe procedurave administrative. Mësuesit duhet të kenë një “mendësi zhvillimi” në mënyrë që të mund të ndihmojnë nxënësit e tyre të bëhen nxënës aktivë. Të nxënit ka të bëjë me largpamësinë për të shqyrtuar talentet, mundësitë e të nxënit dhe strategjitë e reja për zgjidhjen e problemeve, dhe jo të shohë nga e shkuara për të kategorizuar fëmijët në nivele arritjeje, duke u mbështetur vetëm në rezultatet e provimeve.


Komuniteti i Platformës "LearnIn" përqafon identitetin e mësuesit, nxit aftësitë dhe kompetencat e tyre dhe synon të fuqizojë rolin personal dhe kolektiv të mësuesve, gjithashtu dhe ndjesinë e tyre të efikasitetit vetjak. Platforma "LearnIn" nuk ofron zgjidhje të gatshme, përkundrazi, ajo mbështetet në premisën që vetëm zgjidhjet që janë të harmonizuara me nevojat, interesat dhe pikat e forta të secilit nga personat e përfshirë do të jenë të qëndrueshme në planin afatgjatë. Platforma "LearnIn" synon që të arrijë jo vetëm të nxënit si një përvetësim njohurish, por gjithashtu të nxënit që transformon dhe zgjeron mendësinë e agjentëve, kapacitetin për të nxënë, dhe aftësinë për të koordinuar veprimet që lidhen me Pedagogjinë, Teknologjinë në Arsim dhe Politikat dhe Administratën për të kapërcyer barrierat e të nxënit. Platforma "LearnIn" ndihmon në krijimin e mundësive ku mësuesit të mund të përfetojnë “të nxënit krijues” si rezultat i bashkëpunimit të efektshëm me kolegët për të arritur zhvillimin dhe transformimin e praktikave të tyre.

Koncepti i “Zotësisë” - Për çfarë?

Zotësia është cilësia e të pasurit të zotësive të nevojshme për një jetë të mirë. Arritja e zotësisë është synimi më i lartë i të nxënit gjatë gjithë jetës; arsyeja përse njerëzit jetojnë dhe nxënë. Koncepti i “zotësisë” përmbledh kompetencat e fituara, ndjesinë e rolit të vetes ose autorësisë, aftësinë për të shfrytëzuar burimet e disponueshme, për të tejkaluar barrierat dhe për të përjetuar jo thjesht kompetencën, por gjithashtu autonominë vetjake dhe përkatësinë shoqërore. Kompetenca është cilësia e të qenit kompetent për të zgjidhur probleme të caktuara ose për të trajtuar problematikat. Të jesh kompetent do të thotë të përvetësosh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që

konsiderohen të rëndësishme për të pasur një rritje dhe zhvillim afatgjatë të efektshëm. Performanca është cilësia e të qenit i aftë për të kryer një detyrë ose veprimtari të caktuar.

Objekti kryesor i kurrikulës kombëtare është arritja e zotësive, që përshkruhet nëpërmjet synimeve afatgjata të arsimit në mënyra që janë të harmonizuara me shoqërinë, kulturën, ekonominë, besimin fetar dhe gjuhën e një vendi (disa nga karakteristikat). Këto pritshmëri abstrakte ndaj qytetarëve të ardhshëm janë vendosur në funksion bashkërisht me kompetencat (shumica e kurrikulave të sotme) ose me përmbajtjet, sjelljet e pritshme ose aftësitë. Në kurrikulat e bazuara në kompetencë, kompetencat janë vendosur në funksion bashkërisht me performanca të vlerësueshme dhe të matshme. Performanca është një detyrë e caktuar që mund ose jo të konsiderohet një tregues i vlefshëm i kompetencës.



Zakonisht, mësuesit dhe prindërit besojnë ose nxiten të besojnë që performanca parashikon ose provon në mënyrë të besueshme kompetencën dhe se vetëm fëmijët me rezultate të larta do të bëhen qytetarë të zotë. Fëmijët dhe të rinjtë që nuk janë në gjendje të kryejnë veprimtaritë apo detyrat në mënyrën se si kërkohet nga mësuesit konsiderohen sikur kanë dështuar. Mësuesit dhe arsimtarët e tjerë mund të jenë të mendimit se vetëm nxënësit që kanë rezultate të larta janë të aftë për të nxënë në mënyrë efikase. Si pasojë, mbështetja e autonomisë dhe përfshirja shoqërore lihen pas dore, për shkak se rëndësia e aftësisë vetërregulluese, për të bërë zgjedhje pozitive dhe për të ndërvepruar në mënyrë të suksesshme me të tjerët, janë të nënvleftësuar. Duke ngushtuar kurrikulën dhe zgjeruar kontrollin, të nxënës përkeqësohet në vend që të përmirësohet. Krahas kësaj, mësuesit bazohen tek e shkuara për të shpjeguar arsyen se përse nxënësit dështojnë dhe nuk shohin përpara me qëllim që të zhvillojnë mënyra të personalizuara për të ndihmuar në fitimin e aftësive. Përcaktimi i qëllimeve udhëhiqet nga pritshmëritë e ulëta të mësuesve dhe jo nga vizioni për të pasur një jetë të mirë.

Platforma "LearnIn" përqendrohet te kompetencat dhe mënyrën se si kompetencat e ndryshme konsolidohen për të përmirësuar aftësinë e mësuesve, nxënësve ose prindërve për të pasur një jetë të mirë. Platforma "LearnIn" mbështetet në premisën se nuk ekziston një mënyrë e vetme për t'u bërë kompetent. Gjithashtu, bërja e ndonjë gabimi apo ndërprerja e diskutimit përshpejton të nxënit më tepër se sa sjellja shembullore dhe performanca e pritshme. Për shkak se të pasurit një jetë të mirë varet gjithashtu dhe nga marrëdhëniet me të tjerët, edhe të nxënit bashkëpunues është i rëndësishëm. Krahësja, interesat dhe motivimi personal janë faktorë kyç që ndikojnë në nxënit. Ndjesia e autonomisë dhe vetëvendosja përmirësojnë përvojën e të nxënit dhe shërbejnë si ndihmesë për personin(at) veprues për zhvillimin e strategjive që funksionojnë me mirë në punën e tyre.

Koncepti i “Njohurive të disiplinës” - Çfarë?

Të nxënit ka gjithmonë të bëjë me diçka, dhe kur bëhet fjalë për të nxënit e njeriut, kjo diçka mund të jetë çfarëdolloj gjëje. “Njohuritë e disiplinës” përshkruajnë atë që ne mësojmë. Përgjatë historisë së njeriut, dija e disponueshme është zhvilluar për të adresuar problemet dhe sfidat që hasen për të pasur një jetë të mirë. Njohuritë janë zhvilluar në disiplina ose fusha kurrikulare të ndryshme dhe, si rrjedhojë, dhe disiplinat janë zhvilluar në fusha të specializuara ose nëndisiplina. Njohuritë e përgjithshme të disiplinës në platformën "LearnIn" janë “Arsim gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë”, njohuri disipline që përfshijnë, ndër të tjera, Didaktikën, Filozofinë e Arsimit, Legjislacionin e të Drejtave të Njeriut, Arsimin Special, Psikologjinë, Sociologjinë, Shkencat Politike, të Nxënit digjital dhe Informatikën, Menaxhimin dhe Drejtimin. Ajo mbështetet në të gjitha njohuritë e disiplinave që përbëjnë tre shtyllat e platformës "LearnIn": “Pedagogjinë”, “Teknologjinë në Arsim” dhe “Politikat dhe Administrimin”. Një tjetër fushë njohurish kryesore është mënyra më e mirë se si njohuritë krijohen, strukturohen dhe ndahen për të qenë të efektshme. Platforma "LearnIn" përdor “Komunitetet Profesionale” për të zhvilluar “ekspertizën brenda një rrjeti” që ka të bëjë me disiplina dhe mjedise të ndryshme.

Çdo ditë, mësuesve iu duhet të përballen me probleme të ndërlikuara shoqërore dhe njerëzore në klasat e tyre që duhet të adresohen, por që shpeshherë e kanë zanafillën jashtë sferës së tyre të influencës. Disa prej nxënësve mund të jenë të pavëmendshëm, me depresion ose të uritur për shkak të disavantazhit social të familjeve të tyre. Fëmijët me aftësi të kufizuara përfitojnë nga pjesëmarrja shoqërore në klasa të zakonshme, por mund të mos marrin mbështetjen e nevojshme për të nxënë. Shpesh, përdorimi i njohurive nga një disiplinë (krijimi i marrëdhënieve të qëndrueshme) mund të bjerë drejtpërdrejt ndesh me njohuritë nga një disiplinë tjetër (shtimi i kohës së angazhimit në mësimin e përmbajtjes së lëndës). Me qëllim që të tejkalohen këto situata kontraktore, mësuesit duhet të analizojnë mënyrën se si mendojnë.

Të nxënit tradicional i mësuesit, për shembull në formimin fillestar të tyre, fokusi ka qenë te njohuritë mbi lëndën për klasat e larta dhe te njohuritë metodologjike për klasat e ulëta. Si pasojë, mësuesit e lëndës dhe mësuesit kujdestarë përqendrohen në njohuri lëndësh të ndryshme kur përpiqen të zgjidhin probleme së bashku. Prindërit mund t'i japin më tepër rëndësi zgjidhjes së problemeve të përditshmërisë dhe nuk i kushtojnë vëmendje promovimit të të nxënit akademik. Nxënësit mund të jenë më të përqendruar në shmangien e dështimeve dhe zhgënjimeve të mëtejshme dhe jo te zgjerimi i njohurive të tyre në Matematikë. Kjo gjë mund të sjellë keqkuptime dhe mund të shkaktojë konflikt ose marrëdhënie ku mungon bashkëpunimi.

Platforma "LearnIn" mbështet përvetësimin, ndarjen dhe krijimin e njohurive të nevojshme për të adresuar probleme të ndërlikuara që mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet bashkëpunimit. Ky material propozon një gjuhë dhe strukturë të përbashkët që mund të përshtatet dhe bashkërendohet me nevojat dhe interesat e komunitetit ku do të zbatohet. Platforma "LearnIn" zgjeron njohuritë dhe mbështet zhvillimin e aftësive metakognitive të nevojshme për të shfrytëzuar njohuritë për zgjidhjen e problemeve. Meta-njohuritë janë njohuritë që përfshijnë njohuri disiplinash të ndryshme për të mundësuar një kuptim të mënyrës se si njohuritë mund të zhvillohen, të integrohen dhe të zbatohen.

Ky Manual do të zgjerohet gjatë përdorimit të tij teksa komuniteti i platformës "LearnIn" do të zhvillojë njohuri të reja, shembuj të mirë praktike, materiale dhe procedura. Integrimi i njohurisë dhe bërja e njohurisë të aksesueshme janë qëllimi i përbashkët i njohurive. Në një fazë të parë, vëmendja do të jetë në njohuritë e disiplinave të mëposhtme për të adresuar krizën aktuale të COVID-19: Mbështetja e nxënësve që nuk po ndjekin shkollën gjatë izolimit (Ëorkshop-i 1), Mirëpritja e nxënësve në shkollë (Ëorkshop-i 2), Krijimi i mënyrave të personalizuar të të nxënit për nxënësit (Ëorkshop-i 3). Më tej, këto njohuri disiplinash do të zgjerohen për të pasur një fokus më të përgjithshëm te grupet e fëmijëve pa ose me akses të kufizuar në arsim.

Koncepti i “Kontekstit” - Ku?

Në përgjithësi, termi “kontekst” i referohet mjedisit fizik, shoqëror, kulturor, gjuhësor dhe politik në të cilin zhvillohet një veprimtari. Konteksti i referohet vendit “ku” diçka kryhet, për shembull ku kryhet të nxënit. Këto rrethana krijojnë kushtet ose shërbejnë si bazë për të gjitha veprimtaritë njerëzore. Mësimdhënia dhe të nxënit mund të kuptohen plotësisht vetëm nëse merret në konsideratë konteksti. Kontekstet e ngushta ose të afërta i referohen mjedisit të menjëhershëm dhe atij që paraprin dhe ndjek menjëherë një veprimtari. Kontekstet e gjera ose të largëta i referohen një mjedisi të gjerë dhe të zgjeruar, si dhe perspektivës afatgjatë mbi atë që paraprin dhe ndjek një veprimtari. Ideja e mjedisëve “të afërta” dhe “të largëta” që ndikojnë te mësuesi dhe te veprimtaritë mësimore është baza për të kuptuar sistemet e ndërlikuara. Teoria e sistemeve

ekologjike bën dallimin ndërmjet mikrosistemeve (konteksti në klasë), mesosistemeve (shkolla në komunitetin vendas) dhe makrosistemeve (konteksti kombëtar arsimor).

Një prej elementëve kyç të praktikës së mirë të mësimdhënies është krijimi i mjediseve që mundësojnë të nxënit. Konteksti parësor për të nxënit formal është mjedisi në klasë, por mësuesit përdorin gjithashtu mjedise të tjera si muzetë ose natyrën për të lehtësuar të nxënit. Organizimi fizik i klasës dhe atmosfera shoqërore në të cilën zhvillohet mësimi kanë një ndikim të konsiderueshëm te pjesëmarrja dhe të nxënit. Rregullat dhe rregulloret e zhvilluara në kontekstin e gjerë të sistemit kombëtar arsimor ndikojnë te veprimet, besimet dhe pritshmëritë e mësuesve. Situata në familje e fëmijëve ndikon në aftësinë e tyre për t'u përqendruar dhe për t'iu përshtatur stileve të ndërveprimit të mësuesve të tyre. E thënë ndryshe, kontekstet e largëta ndikojnë në kontekstet e afërta. Kjo ndodh dhe anasjelltas: ndryshimet në nivelin bazë mund të kenë një ndikim afatgjatë te shkollat dhe sistemet arsimore.

Mjediset tradicionale mësimore janë klasat me banka të përcaktuara, orare jofleksibël dhe mundësi të kufizuara për të krijuar mjedise pozitive mësimore në të cilat të gjithë fëmijët mund të ndihen të mirëpritur dhe të jenë në gjendje të krijojnë marrëdhënie dhe të nxënë në mënyrë aktive. Në mënyrë që të gjithë fëmijët të mund të kryejnë të njëjtën detyrë në të njëjtën kohë kërkohet një menaxhimi i rreptë i klasës. Nxënësit që nuk mund të ndjekin kurrikulën siç paraqitet nga mësuesi, ngelen pas me mësimet dhe rrezikojnë të përjashtohen. Mjediset mësimore përtej klasës nuk konsiderohen të efektshme, ose konsiderohen me rëndësi dytësore. Klasat tradicionale konsiderohen si mjedisi më i mirë për të mësuar, pavarësisht mungesës së provave që një sistem i tillë iu mundëson të gjithëve që të nxënë.

Platforma "LearnIn" thekson rëndësinë e konteksteve të të nxënit, qoftë për të nxënit të mësuesve, po ashtu dhe të nxënësve. Npërmjet përjetimit të të nxënit në kontekste të ndryshme, online dhe përballë, mësuesit arrijnë që jo vetëm të përvetësojnë njohuri të reja, por ajo që është më e rëndësishme, të zgjerojnë repertorin e tyre për krijimin e mundësive të të nxënit në kontekste të ndryshme. Konteksti i të nxënit përfshin elementë të dukshëm dhe të padukshëm. Për shembull, qëndrimet dhe pritshmëritë e mësuesve mund të krijojnë mjedise mësimore që janë të hapura, që ofrojnë mbështetje dhe lehtësira, ose mjedise të ngushta, të pandryshueshme dhe që kufizojnë aftësitë. Platforma "LearnIn" synon të mbështesë mësuesit që të përqafojnë një mendësi zhvillimi me premisën që çdo fëmijë mund të nxërë e të zhvillojë kompetencat dhe zotësinë e vet. I kuptuari ekologjik ndihmon në identifikimin e barrierave të të nxënit, duke përfshirë dhe ato jashtë klasës.

Çdo veprimtari mësimore është e rrënjësuar thellë në kontekst dhe mund të përmirësohet thjesht duke përmirësuar mjedisin mësimor. Megjithatë, edhe mjediset më të zhvilluara mësimore mund të paraqesin barrierë ndaj të nxënit nëse mësuesit ose nxënësit nuk ndihen rehat apo kanë mungesë të strategjive për shfrytëzimin e burimeve të

disponueshme. Kontekstet e të nxënit bashkëpunues, të tilla si komunitetet profesionale ofrojnë mundësi për hulumtim. Platforma "LearnIn" mbështet zhvillimin e mjediseve që mundësojnë të nxënit, në internet dhe jashtë tij.

Koncepti i “Mjeteve” - Si?

“Mjet” është një term i përgjithshëm për mënyrat, strategjitë, pajisjet ose procedurat e zbatuara, veçanërisht ato që lidhen me të nxënit dhe mësimdhënien. Mjetet përshkruajnë se si kryhet diçka, për shembull si realizohet të nxënit. Kur kombinohen mjete, materiale dhe pajisje të caktuara, së bashku ato përbëjnë një qasje ose metodologji. Librat, letra dhe lapsi janë mjetet e zakonshme që përdoren gjatë mësimdhënies dhe të nxënit. Mjetet e shekullit të 21-të përfshijnë pajisjet e komunikimit dhe të nxënit digjital që përdoren në klasë ose në shtëpi. Mjetet mund të përdoren nga individë ose grupe, madje dhe nga vende. Për shembull, kurrikula kombëtare është një mjet që përçon pritshmëritë shoqërore ndaj njohurive, kompetencave dhe vlerave të nxënësve të mësuesit dhe në klasë. Mjetet mund të përdoren për të ndërmarrë veprime të menjëhershme (për shembull, prerja e letrës me gërshërë) ose për veprimtari të zgjatura (për shembull mjetet ndërvepruese për bashkëpunim dhe dokumentim).

Praktikisht, çdo mënyrë e përdorur për të kryer një veprimtari ose detyrë mund të konsiderohet si një mjet. Mjetet e thjeshta mund të jenë të disponueshme në shumicën e konteksteve (për shembull letra dhe lapsi), ndërsa mjete të tjera (për shembull programet softuer për të mësuar) kërkojnë mjedise të posaçme mësimore dhe nivel të lartë njohurish digjitale nga mësuesit dhe nxënësit. Gjithashtu, gjuha është një tjetër mjet i rëndësishëm mësimor për komunikimin dhe për të pasur akses në njohuri. Modelet mendore janë paraqitje të brendshme të mënyrës se si duhet të adresohen probleme të ndryshme apo se si duhet të mësohet. Këto modele janë gjithashtu mjete, pasi ato ndihmojnë në lehtësimin e aksesit të nxënësve në njohuritë e disiplinës. Një rol i rëndësishëm i arsimit është transformimi i modeleve mendore, koncepteve, supozimeve dhe besimeve dhe zgjerimi i kapacitetit për të nxënë.

Mësimdhënia tradicionale mbështetet në një grup të kufizuar mjedesh dhe në besimin se një qasje e vetme ndaj të nxënit është e përshtatshme për të gjithë nxënësit. Ajo i udhëheq nxënësit nëpërmjet mënyrave të pandryshueshme dhe të paracaktuara të të nxënit dhe nuk merr në konsideratë stilet apo parapëlqimet e ndryshme të të nxënit. Mësimdhënia tradicionale nuk iu përshtatet nevojave të veçanta të nxënësve, për shembull ajo nuk ofron mjete ose materiale alternative që mund të aksesohen nga fëmijët me aftësi të kufizuara. Gjithmonë e më shumë politikat synojnë që të realizojnë sisteme arsimore gjithëpërfshirëse, si dhe të sfidojnë besimet e mësuesve dhe prindërve mbi mënyrat më të mira të të nxënit për fëmijët. Vazhdimisht zhvillohen mjete të reja për të ndihmuar praktikën e mësuesve (për shembull protokolle për planifikimin arsimor individual) dhe për të ndihmuar nxënësit që të nxënë (për shembull përshtatja e

materialeve për fëmijët me performancë më të ulët), por shpeshherë, veprimtaritë e përgjithshme të mësimdhënies dhe të nxënësve nuk përshtaten për të përfshirë këto mjete të reja. Krahësia kësaj, këto mjete mund të bien ndesh apo të pengojnë në arritjen e qëllimeve të përgjithshme të nxënësve (për shembull që nxënësit të arrijnë të bëhet autonomë dhe të kenë ndjesinë e përkatësisë). Gjithashtu, mjetet mund të përdoren dhe për qëllime të paparashikuara (për shembull përdorimi i kompjuterit për të luajtur lojëra në vend që të mësohet), madje dhe për qëllime të padëshiruara (për shembull mësimdhënia duke përdorur testet në mënyrë që të përmirësohen rezultatet, gjë e cila kufizon më tej kurrikulën).

Platforma "LearnIn" vendos theksin te fakti që mjetet janë të efektshme vetëm nëse mësuesit dhe nxënësit dinë si t'i përdorin ato. Mjetet duhet të bëhen pjesë e veprimtarive mësimore dhe të kontribuojnë në rezultatet e pritshme të nxënësve. Procedurat administrative duhet të përshtaten me stilin e bashkëpunimit dhe mënyrën e të punuarit të mësuesve. Gjithashtu, është relativisht e lehtë që klasat të pajisjen me kompjuterë, megjithatë kjo nuk siguron që ata do të përdoren si mjete mësimore efikase. Nxënësit dhe mësuesit duhet të fuqizohen dhe mjetet duhet të përshtaten me stilet e të nxënësve në mënyrë që të mbështesin të nxënësve dhe mësimdhënien. Mësuesve dhe nxënësve iu duhet të transformojnë veprimtarinë e tyre të përgjithshme në mënyrë që të shfrytëzojnë më së miri teknologjitë e reja.

Platforma "LearnIn" ofron jo vetëm mjete, por ofron gjithashtu dhe një metodologji të integruar dhe mundësi të nxënësve për t'u njohur dhe ambientuar me përdorimin e mjeteve të tilla. Manuali "LearnIn" sugjeron jo vetëm teknika dhe mjete të reja, por ofron edhe mbështetje për mësuesit dhe nxënësit që t'i përdorin mjetet e disponueshme në mënyrë më efikase.

PJESA 1: MBËSHTETJA E NXËNËSVE GJATË IZOLIMIT NË SHTËPI

Si të mbështesim nxënësit në shtëpi: Analiza e situatës

Kriza aktuale e COVID-19 po evidenton problemet dhe sfidat e të nxënësve në situata kur arsimi formal nuk është i disponueshëm. Aktualisht, kjo është një situatë që po përjetohet nga mësuesit dhe nxënësit e tyre në shumë vende të botës. E drejta për arsim nuk është më e mbrojtur dhe sistemet arsimore po hasin vështirësi në gjetjen e mënyrave për të arritur të nxënësit dhe për të siguruar vazhdimësinë e të nxënësve. Gjithashtu, kriza aktuale po kërcënon jetesën e familjeve, po çorienton rutinat e përditshme, po krijon tensione midis pjesëtarëve të familjes si dhe po shkakton stres psikologjik. Kufizimet e vendosura për individët dhe jetën qytetare kanë pasoja shumë të gjera në komunikim, marrëdhënie dhe gëzimin e të drejtave themelore të njeriut.

Ndonëse për pjesën më të madhe të familjeve kjo është një gjendje kalimtare, për disa është një shqetësim i përhershëm. Shumë familje të disavantazhuara dhe fëmijë të cenueshëm përjetojnë një ndjesi të tillë përjashtimi dhe izolimi për periudha të zgjatura kohe ose edhe përherë. Edhe në ditët e sotme, në shumë vende, jo të gjithë fëmijët kanë akses në arsimin formal dhe vazhdojnë të mos ndjekin dot shkollën. Fëmijët në lëvizje, për shkak të kushteve të panjerëzishme të jetesës ose konflikteve të armatosura nuk ndjekin dot shkollën ose kanë ndërprerje të shumta të arsimimit të tyre ndërkohë që kërkojnë azil. Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara ose me probleme shëndetësore kronike ndërpritet sa herë ata detyrohen të shkojnë në shkollë të veçanta apo kur është e nevojshme që të shtrohen në spital. Familje dhe fëmijë të tjerë janë të izoluar nga shoqëria ose gjeografikisht, dhe duhen adresuar shumë pengesa për të arritur pjesëmarrjen e tyre në shkollë.

Problemet që përjetojnë mësuesit, prindërit dhe fëmijët në situata të tilla janë komplekse dhe të ndërvarura dhe situata e secilit prind, mësues dhe fëmijë është unike. Të gjithë mund të ballafaqohen me nevojat dhe qëllime që bien ndesh me njëra-tjetrën, për shembull mësuesit mund të dëshirojnë të arrijnë të gjithë fëmijët, por mund të përjetojnë situata stresuese në jetën e tyre, të shkaktuara nga konfliktet në shtëpi, nga pasiguria në lidhje me përgjegjësitë e tyre profesionale ose mungesa e kohës dhe burimeve. Nuk ka zgjidhje të lehtë ose të gatshme për të mbështetur nxënësit jashtë shkollës. Por ka disa çështje kyçe që duhen të adresohen dhe të zgjidhen:

- Së pari, duhet të adresohen nevojat bazë, si për shembull nevojat që lidhen me sigurinë, ushqimin, strehimin
- Rutinat janë ndërprerë dhe krijimi i rutinave të reja kërkon pak kohë.
- Mënyrat e zakonshme që mbajnë marrëdhëniet dhe bëjnë të mundur komunikimin janë ndërprerë dhe duhet të rivendosen

Kriza aktuale e COVID-19 po zbeh rolet e mësuesve, prindërve dhe nxënësve pasi ka vështirësuar ndarjen midis jetës profesionale dhe personale, midis kohës së lirë dhe

mësimi. Nxënësit mund të kenë më shumë njohuri se mësuesit në përdorimin e pajisjeve të komunikimit ndërsa prindërit e kanë gjetur veten papritmas në rolin e mësuesit. Të parit televizor është kthyer në një përvojë edukuese, e ndjekur ndoshta nga një detyrë e përgatitur nga mësuesi. Kuzhina është shndërruar në një mjedis mësimor dhe vëllezërit dhe motrat në komunitete mësimore. Situata e re përmban shumë sfida, por edhe mundësi.

Mësuesit, prindërit dhe nxënësit ndajnë paqartësitë dhe risinë e përjetimit të këtyre rrethanave të jashtëzakonshme. Nëse udhëhiqen nga i njëjti vizion, kjo situatë kërcënuese mund të shndërrohet në një mundësi unike për të thelluar marrëdhëniet, për të fituar një kuptim më të mirë të të nxënësve dhe për të identifikuar mjetet dhe kontekstet e reja për të mbështetur mësimin për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë.

Si të mbështesim nxënësit në shtëpi: Çështjet dhe pyetjet kyçe

Si të kuptojmë situatën e nxënësve jashtë shkollës duke u përqendruar te nxënësit (kush?)

Pyetjet kryesore:

- Çfarë duhet të di për gjendjen e nxënësve të mi në shtëpi?
- Si mund të zbuloj nëse nxënësit e mi janë gati të mësojnë?
- Çfarë mund të bëj për të mbështetur mirëqenien e vazhdueshme të nxënësve dhe gatishmërinë për të mësuar?

Nxënësit nuk mund të përkushtohen në veprimtari mësimore nëse nuk u sigurohet mirëqenia bazë. Detyra e parë e mësuesve është të kontaktojnë nxënësit e tyre, të rivendosin marrëdhëniet me ta dhe të sigurojnë plotësimin e nevojave themelore siç janë siguria fizike, ushqimi dhe mbështetja emocionale. Vetëm atëherë fëmijët dhe të rinjtë do të jenë gati për të mësuar. Pyetjet e mëposhtme do t'ju ndihmojnë të kuptoni në çfarë situatash gjenden aktualisht nxënësit tuaj:

Si mund të lokalizoj dhe kontaktoj nxënësit e mi?

Në përgjithësi, mësuesit kanë akses në të dhënat private të kontaktit të nxënësve të tyre. Nëse informacioni i disponueshëm nuk është i mjaftueshëm, plotësimi i tij do të jetë një nga detyrat e para. Duhet të shqyrtohen të gjitha metodat e disponueshme për të kontaktuar familjet dhe kanalet më të suksesshme që mund të përdoren për të vendosur kontaktet. Mësuesit duhet të kërkojnë mbështetje nga të tjerët nëse është e nevojshme dhe të japin udhëzime të qarta për informacionin që u nevojitet nga prindërit dhe nxënësit.

Si mund të rikrijoj marrëdhëniet me nxënësit e mi dhe prindërit e tyre?

Në situata krize, arsimi formal nuk është shqetësimi i parë i askujt - as i prindërve e as i fëmijëve. Pa kontakte të përditshme, ju nuk mund të dini nëse fëmijët dhe prindërit po përjetojnë stres aq të lartë sa mund të mos jenë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë aktive në veprimtari mësimore. Mënyra e vetme për të zbuluar se si ndihen fëmijët, nëse janë të sigurt dhe nëse po kujdesen për ta, është duke ndërvepruar drejtpërdrejt me prindërit dhe fëmijët. Komunikimi me dy drejtime (p.sh. nëpërmjet telefonit, takimeve online) preferohet më shumë sesa qasjet e njëanshme (p.sh. email, letra).

Si mund të mbështes mirëqenien e nxënësit dhe familjes së tij?

As prindërit dhe as fëmijët nuk do të jenë të gatshëm të angazhohen në mësimet përveçse nëse mirëqenia e tyre është e sigurt. Ndikimi i mbylljes së shkollave mund të jetë shumë i ndryshëm në varësi të situatës specifike të jetesës. Jo të gjithë prindërit mund të jenë në gjendje t'u shpjegojnë fëmijëve të tyre se çfarë po ndodh dhe çfarë duhet të presin. Prindërit mund të humbasin të ardhurat e tyre ose burimet e rëndësishme mund të mos jenë të disponueshme. Disa familje mund të përjetojnë stres dhe kalimi i shumë kohe së bashku mund të shtojë incidentet e dhunës në familje dhe probleme të shëndetit mendor. Përdorimi i internetit përmban kërcënimet e veta (bullizmi kibernetik, shfaqja e përmbajtjeve të dhunës ose përmbajtjeve traumatizuese në mënyra të tjera). E rëndësishme është që mësuesit të jenë të vetëdijshëm dhe të mbështesin ndjenjën e vetë-efikasitetit të nxënësve dhe prindërve, si dhe mirëqenien e tyre.

Si mund ta ndihmoj nxënësin tim të ruajë motivimin?

Nxënësit, prindërit dhe mësuesit mund të ndihen të zhgënjyer kur aktivitete që ata i prisnin me dëshirë anulohen. Kjo mund të jetë një përvojë shumë dëshpëruese për të gjithë dhe nxënësit mund të humbasin motivimin e tyre për të punuar, veçanërisht kur janë të shpëputur nga miqtë e tyre më të mirë dhe veprimtaritë e preferuara. Pa motivim, mësuesit nuk do të jenë në gjendje t'i detyrojnë nxënësit të mësojnë në distancë. Përdorimi i motivuesve të jashtëm si tërheqja ndaj mjediseve digjitale dhe krijimi i motivit të brendshëm duke marrë parasysh interesat dhe talentet e nxënësve, do të ndihmojnë në nisjen dhe vazhdimin e të nxënësve. Gjithashtu, përfshirja në veprimtari online së bashku me nxënësit e tjerë dhe përforcimi pozitiv i shpeshtë nga prindërit dhe mësuesit do të jenë të dobishëm. Kujdesuni që të mos bëni premtime që nuk mund t'i mbani thjeshtë për të motivuar nxënësit ndërkohë që përpiqeni të qëndroni pozitivë dhe t'i bëni nxënësit të kenë shpresë për të ardhmen.

Si mund t'i ndihmoj nxënësit e mi të krijojnë rutina të shëndetshme?

Ruajtja e rutinave të vazhdueshme dhe praktika e zakoneve të shëndetshme janë edhe më të rëndësishme në kohë krize. Sigurohuni që prindërit dhe fëmijët të kuptojnë nevojën për rutinë (p.sh. koha e zgjimit dhe gjumit) dhe rregullit (p.sh. një vend për të studiuar). Kjo do t'i ndihmojë nxënësit të ndjehen të sigurt dhe të fillojnë të mësojnë. Filloni me caktimin e orareve mësimore të menaxhueshme që mund të zgjerohen, por që duhen ndjekur. Kontaktoni familjet në një orar të ditës apo javës për të cilin keni rënë dakord më parë dhe përmbajuni atij orari. Inkurajoni nxënësit të vendosin çdo ditë se

çfarë do të bëjnë ditën tjetër. Sigurohuni që fëmijët të planifikojnë kohën për rekreacion, stërvitje dhe vaktet. Sigurohuni që fëmijët të kenë njohuritë bazë në lidhje me higjienën dhe distancimin fizik.

Si të identifikojmë qëllime kuptimplota për të nxënësit në shtëpi duke u përqendruar në qëllimin e të nxënësit (pse?)

Pyetjet kryesore:

- Si mund të vendos qëllime që kontribuojnë në zhvillimin e zotësive të nxënësit?
- Cilave qëllime duhet t'u jap prioritet dhe si ta bëj këtë?
- Si mund të siguroj që ajo që nxënësit po mësojnë kontribuon në të nxënësit e synuar nga kurrikula?

Kohët e krizës dhe situatat e jashtëzakonshme kërcënojnë përparimin e të nxënësit akademik për shkak se shqetësime të tjera kërkojnë më shumë vëmendje. Nëse fëmijët dhe familjet nuk janë të gatshëm të angazhohen në mësimin akademik, as materialet dhe detyrat më të mira nuk do të kontribuojnë në procesin e të nxënësit. Fëmijët nxënë me ritme të ndryshme në çdo mjedis, por mësimi i bazuar në shtëpi do t'i theksojë këto dallime. Mungesa e rregullit (p.sh. orari i klasës, pushimet) dhe udhëzimeve (mësimet e përgatitura nga mësuesit) është një sfidë për mësuesit, prindërit dhe nxënësit. Por kjo mund të jetë edhe një mundësi për të zhvendosur vëmendjen nga përmbajtja dhe detyrat te qëllimet dhe arritjet. Kjo do t'i lejojë mësuesit, prindërit dhe nxënësit të hartojnë plane mësimore për të përcaktuar përparësitë dhe të mbikëqyrin mënyrat e të nxënësit. Kriza aktuale ka evidentuar gjithashtu përgjegjësinë e përbashkët për të nxënë dhe mënyrat si mund të arrihen qëllimet përmes zgjidhjes së problemeve në bashkëpunim.

Si mund të ndihmoj nxënësit dhe prindërit të kenë pritshmëri pozitive ndaj të nxënësit?

Pritshmëritë e mësuesve janë parashikime për arritjet e ardhshme të nxënësve dhe si të tilla kanë ndikim të fuqishëm mbi nxënësit dhe prindërit. Pritshmëritë e nxënësve i udhëheqin ata në çdo hap që marrin në mënyrën e tyre të të nxënësit. Prandaj, të ndihmosh të gjithë të përfshirët në zhvillimin e pritshmërive të larta është një nga objektivat më të rëndësishme për mësuesit. Mësuesit duhet të ndihmojnë nxënësit dhe prindërit të shohin mundësitë e të nxënësit që ofron kriza aktuale dhe të krijojnë një vizion për atë që fëmija mund të mësojë dhe që do të jetë i dobishëm për tërë jetën e tij / saj. Është e rëndësishme të mbështetni fëmijët dhe prindërit që të kenë një mendësie zhvillimi, duke e vendosur theksin jo mbi atë që fëmija mund apo nuk mund të bëjë, por mbi mënyrën se si mund të mësojë dhe të rritet. Të gjitha këto përpjekje ia vlejnë nëse arrihen qëllimet; të mësosh nga gabimet është më efikase sesa të bësh detyra rutinë.

Si t'ua komunikoj pritshmëritë e mia nxënësve dhe prindërve?

Një nga pasojat e ndërprerjes së mësimin të bazuar në shkollë është se mësuesit nuk janë më të pranishëm fizikisht për të dhënë mësim në mënyrë që të arrihen rezultatet e

synuara të nxënësve. Mësuesit janë të detyruar t'u komunikojnë nxënësve pritshmëritë dhe qëllimet e synuara për ta, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të vetë-rregullojnë të nxënësve të tyre me ndihmën e prindërve ose të tjerëve. Kuptimi i përbashkët i rezultateve të pritura është pika e nisjes në çdo përpjekje për bashkëpunim. Mësuesit duhet të transformojnë mendimin e tyre të orientuar drejt përmbajtjes në qëllime të përqendruara te nxënësit dhe të gjejnë një mënyrë për të përcjellë pritshmëritë kyçe te prindërit dhe nxënësit, në vend që të japin udhëzime. Në vend që të japin reagime mbi çka nuk funksionoi, mësuesit mund të praktikojnë termin “feedforward” (reagim paraprak) që do të thotë të përqendrohen në zhvillimet në të ardhmen, p.sh. të ofrojnë ndihmë për zhvillimin e mënyrave të të nxënësve, të identifikojnë sfidat që mund të adresohen dhe synimet që mund të arrihen.

Si mund të ndihmoj nxënësit dhe prindërit të vendosin qëllime kuptimplota të të nxënësve?
Mësuesit piren t'i kushtojnë më tepër rëndësi synimeve të performancës dhe ta shohin të nxënësve si një nënprodukt të performancës së përmirësuar. Ndërrprerja e mësimi të bazuar në shkollë iu jep mësuesve, prindërve dhe fëmijëve një mundësi për të provuar se e kundërta është e vërtetë. Kapaciteti i shtuar i të nxënësve është rezultati kryesor, ndërsa performanca e përmirësuar është vetëm njëri prej disa treguesve të të nxënësve. Qëllimet kuptimplota të të nxënësve synojnë zgjerimin e veprimtarisë mësimore të nxënësve dhe i ndihmojnë ata të bëhen më të pavarur dhe efikasë, si dhe të zgjidhin problemet në mënyrë më efektive. Ato prekin të gjitha aspektet e veprimtarisë së të nxënësve, duke përfshirë të nxënësve për veten dhe mirëqenien e tyre, të nxënësve për të përcaktuar qëllime efektive, eksplorimin e mjeteve dhe strategjive të reja dhe përdorimin e mjediseve mësimore të panjohura. Gjithashtu, prindërit dhe nxënësit mund të jenë të zënë me probleme të tjera dhe mund të mos u pëlqejë fakti që po u jepen detyra mësimore. Përpikuni të identifikoni qëllimet kuptimplota si për nxënësit dhe prindërit, si për shembull probleme të jetës së përditshme që mund t'i zgjidhin së bashku.

Si mund të zhvilloj plane mësimore të bazuara në qëllime për nxënësit e mi?

Duke qenë se qasja e mësuesve ndaj planifikimit në klasë nuk është më e dobishme, vëmendja duhet të zhvendoset nga çfarë mësuesit kanë planifikuar të japin mësim në atë çfarë nxënësit planifikojnë të nxënë. Pasi të jenë identifikuar qëllimet gjithëpërfshirëse, planet mësimore ose të punës mund të ndihmojnë në sinkronizimin e veprimtarive midis mësuesve, nxënësve dhe prindërve. Përcaktimi i suksesshëm i qëllimeve përfshin hapa dhe elementë që ndihmojnë në arritjen e këtyre qëllimeve. Merrni në konsideratë disiplina të ndryshme mësimore (p.sh. qëllime për zakone në punë, qëllime të fushës së lëndës, qëllime të sjelljes, qëllime të njohurive) ose elementë të kompetencave të ardhshme teksa hartoni planin mësimor. Inkurajoni nxënësit të zhvillojnë planet e tyre të punës, nëse është mundur së bashku me prindërit duke qenë se kjo i kursen kohë mësuesit dhe rrit angazhimin e prindërve në të nxënësve të fëmijëve të tyre. Mësimi i bazuar në qëllime mbështet të nxënësve vetë-rregullues pasi nxënësit mund të zgjedhin mënyrat e tyre të të nxënësve, qasjet dhe mjediset për të pasqyruar situatën e tyre aktuale.

Si mundem unë, nxënësit e mi dhe prindërit e tyre të kontrollojmë qëllimet dhe sa prej tyre janë arritur?

Një plan mësimor do të udhëheqë të nxënësit vetëm nëse të gjithë do e përdornin për të mbështetur këtë proces, jo vetëm për t'ia lënë përgjegjësinë fëmijës. Vlerësimi formues është më i fuqishëm nëse udhëheq nxënësit drejt një qëllimi kuptimplotë. Të kontrollosh qëllimet dhe arritjet e tyre do të thotë të bësh të nxënësit të dukshëm, t'iu ofrosh nxënësve reagime kur arrijnë qëllimet e tyre dhe të dokumentosh arritjet mësimore. Nxënësit mund të monitorojnë progresin e tyre dhe nëse i ndajnë këto informacione me nxënësit e tjerë, ata mund të ofrojnë reagime për bashkëmoshatarët e tyre dhe të kontaktojnë nxënësit e tjerë për të mësuar nga përvojat e tyre të të nxënësit. Arritjet e të nxënësit mund të bëhen të dukshme duke shkëmbyer imazhe, video, materiale audio ose mjete të tjera.

Si të zgjedhim njohuritë përkatëse ose kompetencat e disiplinës duke u përqendruar te procesi i të nxënësit (çfarë?)

Pyetjet kryesore:

- Si mund t'i bëj nxënësit të kenë interes për të mësuar?
- Si të vendos rreth çfarë duhet t'u mësoj?
- Si të sigurohem që nxënësit të përvetësojnë njohuri dhe kompetenca të rëndësishme për kurrikulën?

Pasi nxënësit të jenë të gatshëm për të mësuar, mësuesit duhet të vendosin çfarë duhet që ata të mësojnë. Meqenëse mësuesit nuk janë fizikisht me nxënësit për t'iu udhëhequr gjatë mësimin, dhe prindërit nuk do të kenë as kohën e as kualifikimin për t'u bërë mësues zëvendësues, tema, kompetencat e disiplinës ose njohuritë duhet të kenë rëndësi parësore për nxënësin. Motivimi i nxënësve për të nxënë mund të ruhet vetëm nëse ato që po u mësohen janë të dobishme dhe të rëndësishme për ta. Kriza ofron mjaft mundësi për të praktikuar dhe përmirësuar aftësitë e jetës (p.sh. aftësitë vetë-rregulluese, menaxhimi i pasigurive dhe konfliktit) dhe të mësojnë duke bërë (p.sh. aplikimi i matematikës, gjuhës, biologjisë në situatat e përditshme). Kjo kërkon që mësuesit të ndjekin nxënësit dhe jo e kundërta. Ndonëse ekziston tundimi që thjesht t'i drejtoni nxënësit në një platformë mësimore ose të vazhdoni me planin e klasës, kjo nuk ka për të funksionuar, përveçse kur nxënësit janë të aftë dhe të gatshëm të përqendrohen te përmbajtja dhe ta përdorin atë si një mundësi për të nxënë.

Si mund të orientojnë interesat dhe talentet e nxënësve mësimin?

Interesat dhe talentet e nxënësve janë shtytës të fuqishëm për të mësuar, dhe në kohë krize, është veçanërisht e rëndësishme të theksohen pikat e forta dhe interesat e nxënësve. Nëse lënda ose tema lidhet me interesat e nxënësve, përkushtimi në procesin e të nxënësit do të jetë shumë më i madh dhe rezultatet e tij shumë më domethënëse. Interesat dhe talentet e nxënësve mund të hulumtohen duke u ofruar

atyre të zgjedhin çfarë të mësojnë. Por jo çdo nxënës ka aftësinë të vetë-rregullojë të nxëniet e tij, kështu që për shumë nxënës mund të jetë më e efektshme që të mos u ofrohen shumë mundësi zgjedhjeje, të paktën jo në fillim. Analiza e thellë mbi mundësitë e të nxëniet sipas interesave dhe talenteve të nxënësve mund të ndihmojë në zgjerimin e mendjes së mësuesve mbi çfarë është e rëndësishme të mësohet për kurrikulën. Duke pyetur nxënësit se si angazhimi i tyre me hobet dhe mënyrat e tyre të parapëlqyera për të kaluar kohën kontribuon në të nxëniet dhe përvetësimin e aftësive dhe kompetencave në kurrikul mund të shtojë numrin e arritjeve që mësuesit i konsiderojnë të mundshme.

Si mund të ndihmojnë përvojat e nxënësve në udhëheqjen e të nxëniet?

Të nxëniet kuptimplotë fillon nga ku jemi në këtë moment, lidhet me përvojat tona dhe na ndihmon të ndërmarim hapa përpara në udhëtimin tonë në jetë. Respektimi i përvojave aktuale dhe të kaluara të nxënësve është një kusht paraprak për të filluar të nxëniet kuptimplotë. Prandaj është e rëndësishme të ndihmohen nxënësit që të kuptojnë situatën e tyre aktuale. Të nxëniet që ndihmon në menaxhimin dhe përmirësimin e situatës së nxënësve ka një ndikim të gjatë pozitiv në jetët e tyre. Të nxëniet mund të fillojë me situata të jetës së përditshme të nxënësve dhe familjeve të tyre, si gatimi, pastrimi, mbikëqyrja e vëllezërve e motrave më të vegjël ose thjesht përjetimi i mërzisë apo vetmisë. Nëse përdoren në potencialin e tyre maksimal, këto përvoja promovojnë përvetësimin e shumë kompetencave të rëndësishme për kurrikulën. Ndonjëherë mësuesit nuk i shohin mundësitë e të nxëniet përtej klasës, kështu që kjo është një mundësi që edhe mësuesit të zgjerojnë të kuptuarit e tyre.

Si mund t'i jap prioritet përmbajtjes dhe detyrave përkatëse?

Të nxëniet nëpërmjet vetëdrejtimit kthehet në nevojë në mungesë të mësuesve dhe klasave. Fëmijët e vegjël në veçanti nuk mund të vetëorganizojnë të nxëniet e tyre dhe duhet të udhëhiqen nga mësuesit, prindërit ose të dyja palët. Por mësuesit kanë prirjen të ndajnë përmbajtjen, njohuritë ose temat në një seri detyrash hap-pas-hapi dhe nëse nxënësit nuk kuptojnë një hap, ata rrezikojnë të mos arrijnë qëllimet e përgjithshme të të nxëniet. Pamundësia për të udhëhequr nxënësit në të njëjtën mënyrë kur mësojnë nga shtëpia, mund të zgjerojë qëllimin e mësuesit mbi mënyrat si mund të organizohet mësimi dhe të eksplorojnë mënyrat në të cilat nxënësit zgjedhin detyra nga subjekte ose fusha të ndryshme të kurrikulës. Zotërimi i mësimi është më e rëndësishme sesa qasjet e rafinuara didaktike, të cilat janë veçanërisht të rëndësishme kur përdoren platforma mësimore ose burime të tjera digjitale me hapa mësimore të paracaktuar. Mësuesit duhet t'i ofrojnë të dyja; detyra të hapura dhe detyra të parapërcaktuara për të parë se si nxënësit i menaxhojnë ato. Ka shumë mënyra për të zhvilluar aftësi dhe kompetenca siç parashikohet nga kurrikula.

Si mund të kontrolloj se kush po punon me cilat detyra?

Sigurimi i një përvoje kuptimplotë të të nxëniet për të gjithë nxënësit duket se kërkon shumë nga mësuesi i zakonshëm, i cili tani mund të ketë shumë gjera të tjera për t'u shqetësuar përveç mësimi të nxënësve të tij. Situata si kriza e COVID-19 çojnë këdo

në territore të panjohura dhe mund thjesht të shpresojmë për një kurbë të nxëni në rritje. Është më se e dukshme që në këtë pikë lehtësimi i të nxënit kuptimplotë është më i rëndësishëm sesa dokumentimi i tij. Por kur përgatisin detyra për nxënësit e tyre, mësuesit mund ta bëjnë këtë duke dokumentuar të nxënit në mendjen e tyre. Nxënësit mund të mbajnë ditarë të të nxënit të tyre dhe ta dokumentojnë atë në dosjen e nxënësit. Me qasjet e drejtuara nga nxënësit ndaj dokumentimit, mësuesit mund të kursejnë kohë të çmuar për ta investuar në ofrimin e reagimit dhe inkurajimit.

Si mund ta përdorim unë dhe prindërit situatën e krizës si objekt studimi?

Në kohë krize, ekziston një dëshirë e natyrshme për të mësuar më shumë rreth situatës aktuale; kriza e COVID-19 është gjithashtu një temë dhe njohuri disipline për t'u eksploruar. Nxënësit mund të kenë pyetje që mund t'i përdorin për të intervistuar prindërit ose mësuesin e tyre. Nxënësit mund të inkurajohen të komunikojnë me bashkëmoshatarët e tyre dhe të shkëmbejnë informacione. Qasjet ndaj të dëgjuarit aktiv të përdorur nga mësuesit ndihmojnë në marrjen e njohurive mbi mënyrën e të menduarit dhe kuptuarit të situatës aktuale nga fëmijët, çka ndihmon në shmangien e keqkuptimeve. Aftësia digjitale mund të jetë një nga disiplinat më të spikatura të kompetencave të lidhura me krizën aktuale, por ka shumë më tepër për të mësuar prej saj. Njohuritë rreth qëndrueshmërisë së burimeve, shëndetit, zhvillimit ekonomik, biologjisë janë të gjitha njohuri disiplinash të rëndësishme, si për prindërit ashtu edhe për fëmijët.

Përfitimet nga mjediset mësimore në shtëpi – Të përqendrohemi në kontekstin e të nxënit (ku?)

Pyetjet kryesore:

- Cila është hapësira fizike, shoqërore dhe digjitale e disponueshme dhe e aksesueshme nga nxënësit e mi?
- Si mund të shfrytëzoj më së miri shtëpinë si mjedis ku nxënësit e mi mund të mësojnë?
- Cilat mjedise mësimore digjitale janë të disponueshme dhe sa të aksesueshme janë ato nga nxënësit e mi?

Në dallim nga klasat normale, mësuesit nuk kanë kontroll mbi mjedisin mësimor në shtëpitë e nxënësve të tyre. Disa nxënës mund të kenë mjedise të pasura ku mund të angazhohen në shumë mënyra të të nxënit, ndërsa të tjerët mund të mos kenë vende për t'u angazhuar në veprimtari që kërkojnë përqendrim siç janë leximi ose shkrimi. Mësuesit mund të përpiqen të ndihmojnë nxënësit dhe prindërit të përmirësojnë hapësirat, burimet dhe ndërveprimet në dispozicion, për të krijuar një klimë mësimore pozitive. Mbikëqyrja e të nxënit të nxënësve në një mjedis të ndryshëm, mund të jetë një përvojë "ndriçuese" për mësuesit. Disa nxënës mund të jenë të vështirë për t'u menaxhuar në klasë, por spikasin në një kontekst të të nxënit të vetë-drejtuar, ndërsa

disa të tjerë që pëlqejnë të ndjekin udhëzimet e mësuesve, mund të duken të përhumur. Njohja me kushtet e jetesës së nxënësve do të ndihmojë gjithashtu mësuesit të përshtatin detyrat e klasës me kushtet në të cilat nxënësit po mësojnë gjatë mbylljes së shkollave.

Si mund të informohem për mjedisin aktual të nxënësve të mi?

Përpara se t'u caktojnë nxënësve detyra, mësuesit duhet të zbulojnë nëse nxënësit kanë infrastrukturën e nevojshme për t'i kryer ato. Nxënësve u duhet hapësirë dhe kohë për t'u përfshirë në veprimtari mësimore, njerëz që t'u ofrojnë mbështetje ose t'u bëjnë shoqëri gjatë të nxënësve. Mjete të disponueshme si librat dhe materialet e tjera mësimore, kompjuteri ose pajisje të tjera elektronike, interneti, të pasurit një kopsht, tarracë, bodrum ose hapësirë pune, zgjerojnë mundësitë e të nxënësve. Për shembull, shkëmbimi i vizatimeve, përshkrimeve ose fotove të hapësirës së mësimore të nxënësve në shtëpi me mësuesit dhe nxënësit e tjerë, i ndihmon ata të rilidhen dhe të shkëmbejnë ide, materiale dhe pajisje për t'u siguruar që të gjithë nxënësit janë në kontakt me mësuesit dhe miqtë. Mësuesit mund të mbështeten në këto informacione për t'i ndihmuar nxënësit të gjejnë vendin më të mirë për të studiuar në mjedisin e tyre në shtëpi.

Si mund t'i mbështes nxënësit dhe prindërit për krijimin e një mjedisi mësimor pozitiv?

Hapësira fizike dhe infrastruktura e disponueshme janë të rëndësishme, por një mjedis mësimor pozitiv kërkon gjithashtu marrëdhënie mbështetëse, një ndjesi sigurie, qartësi në lidhje me rregullat dhe besim. Marrëdhëniet mësues-nxënës mund të duken të vështira për t'u mbajtur, por ato janë më të rëndësishme se kurrë në kohën kur nxënësit ndihen të izoluar dhe të vetmuar. Mësimi me shokët dhe mundësitë për shkëmbimin e përvojave dhe krijimin e mjediseve mësimore bashkëpunuese duhet të inkurajohen nga mësuesit. Mësuesit duhet të japin informacion bazë dhe këshilla se si prindërit mund të krijojnë mjedise mësimore pozitive për fëmijët e tyre.

Si mund të përdoret mjedisi në shtëpi i nxënësve si një mjedis mësimor?

Çdo mjedis ofron mundësi të të nxënësve, por mësuesit mund të kenë nevojë të mendojnë jashtë kornizave të mësimdhënies tradicionale në klasë. Eksperimentet në lëndët e fizikës, kimisë dhe biologjisë mund të kryhen në kuzhinë ose banjë, ndërsa gatimi ofron mundësi për lëndën e matematikës dhe leximit. Problemet që hasen në jetën e përditshme mund të shqyrtohen, të adresohen dhe zgjidhen. Veprimtaritë e nxënësve, si video lojërat, mund të diskutohen dhe të përdoren për të mësuar, për shembull duke përgatitur një prezantim për video lojën e tyre të preferuar. Mund të reflektoni mbi rutinën dhe zakonet dhe t'i ndani ato me nxënësit e tjerë përmes kanaleve të disponueshme të komunikimit. Mund të jepni këshilla dhe udhëzime për të përmirësuar mjedisin në shtëpi, për të mësuar se si të bashkëpunojnë me anëtarët e familjes dhe të menaxhojnë situata stresuese. Të gjitha këto kontribuojnë për të nxënësve. Nxënësit mund të marrin përsipër rolin e mësuesit dhe të zhvillojnë ushtrime ose detyra që duhet të zgjidhen më pas nga nxënësit e tjerë.

Si mund t'i përshtat detyrat e klasës me mjedisin në shtëpi?

Detyrat e që parashikohen të zgjidhen në klasë, nuk janë domosdoshmërisht funksionale dhe në mjedisin e shtëpisë. Në fakt, udhëzimet me shkrim në vend të atyre me gojë, mund t'i ngatërrojnë lehtësisht nxënësit apo të shkaktojnë keqkuptime. Pasiguria mund të shtohet kur mësuesi i prezanton detyrat nëpërmjet mediave ose kanaleve të ndryshme të komunikimit. Disa nxënësve mund t'iu vijnë në ndihmë demonstrimet, udhëzimet me video të shkurtra ose një mesazh audio. Detyrat që zëvendësojnë të nxënësve në klasë nuk mund të krahasohen me “detyrat e shtëpisë”, që kanë për qëllim pasurimin dhe ripërsëritjen e mësimit. Përdorimi i parimeve të Dizajni Universal i të Nxënësve, mund t'i ndihmojë mësuesit të përshtatin të nxënësve me nevojat e nxënësve në shtëpi dhe t'i ndihmojë ata të përdorin më së miri këtë mjedis.

Si mund t'i mbështes nxënësit që të përdorin me efikasitet mjediset mësimore digjitale?

Të nxënësve digjital është një veprimtari mësimore komplekse dhe për të qenë kuptimplotë duhet që përmbajtja digjitale, mjetet dhe mjediset mësimore të jenë në përputhje me objektivat e përgjithshme të të nxënësve. Nëse mësuesit kërkojnë të promovojnë të nxënësve bashkëpunues, mjetet e përdorura duhet që ta mundësojnë këtë. Nëse mësuesit duan të sigurohen që të gjithë nxënësit janë në gjendje të përdorin me efikasitet të nxënësve digjital, ata duhet t'i ndihmojnë që të kuptojnë se si mjediset mësimore digjitale janë të ndryshme nga mjediset e klasës ose të shtëpisë. Disa nxënës shpesh mund të përdorin mediat sociale dhe të menaxhojnë me lehtësi mjetet e komunikimit, por ende nuk janë në gjendje t'i përdorin këto mjete si pjesë e një mjedisi mësimor. Aftësitë digjitale nuk duhet të ngatërrohen me njohuritë digjitale ose kompetencën për të përdorur me sukses përmbajtje, mjete dhe platforma digjitale.

Përdorimi i mjeteve dhe strategjive për të mbështetur nxënësit në distancë – Të përqendrohemi te mjetet mësimore (Si?)

Pyetje kryesore:

- Cilat janë mjetet e përshtatshme që nxënësit mund të përdorin në shtëpi?
- Si mund t'i ndihmoj nxënësit të përmirësojnë strategjitë e tyre të të nxënësve?
- Si të sigurohem që nxënësit po marrin mbështetjen e duhur?

Mjetet që janë të disponueshme dhe të thjeshta për t'i përdorur në klasë mund të mos jenë dhe aq të disponueshme apo ndihmuese për të mbështetur të nxënësve në shtëpi. Për shembull, edhe nëse një kompjuter është pjesë e mjedisit në shtëpi, fëmijët mund të mos jenë të aftë ta aksesojnë apo përdorin atë. Nxënësit mund të jenë ose të mos jenë në gjendje të përdorin libra shkollorë në shtëpi dhe mungesa e aftësive të leximit mund të krijojë barriera shtesë. Por, në vend që të ndihen të bllokuar dhe të heqin dorë, ata duhet të inkurajohen që të hulumtojnë duke përdorur mjete që më parë ishin të panjohura për ta. Pasiguria për të mos ditur nëse diçka funksionon, është një mundësi

e mirë për të provuar pa pasur frikë nga dështimi. Nxënësit mund të provojnë me sukses mënyra të reja të praktikës, të përfaqësimit të ideve ose të zhvillimit të produkteve që shfaqin aftësitë e tyre.

Si mund të mbaj komunikimin në distancë?

Instrumentet dhe mjetet që bëjnë të mundur komunikim të lehtë, kanë një rëndësi thelbësore për mësimin në distancë. Disa mësues mund të kenë krijuar kanale komunikimi me prindërit para krizës COVID-19 dhe janë në gjendje t'i përdorin ato për të mbajtur kontakte. Për mësuesit e tjerë, kjo është një mundësi për të gjetur mënyra komunikimi me prindërit dhe nxënësit që janë të përshtatshme për të gjithë. Pranueshmëria kulturore, zakonet vendase dhe disponueshmëria e pajisjeve të komunikimit do të jenë thelbësore për të vendosur se cilat do të jenë kanalet më të përshtatshme të komunikimit. Mësuesit mund të përfitojnë nga nevoja e shtuar për të komunikuar në distancë, për të mbështetur aftësitë e komunikimit të nxënësve ose duke e kthyer komunikimin në një subjekt studimi. Mund të eksperimentohen mënyra të reja komunikimi, si mesazhet shkollë-shtëpi ose një sistem shkëmbimi materialesh për t'iu mundësuar nxënësve dhe prindërve akses të lehtë në materialet mësimore, udhëzimet ose listat e kontrollit.

Si mund t'i përdor mjetet për të mbështetur mësimin në distancë?

Kur merren në konsideratë mjetet që mbështesin mësimin në distancë, mësuesve mund t'iu vijnë ndërmend pajisje si kompjuterë, programe softuerë dhe aplikacione. Disa mënyra të thjeshta për të mundësuar mësimin në distancë mund të jenë dërgimi i një letre ose karte me postë, dërgimi i detyrave në kutitë e përcaktuara për t'u marrë dhe kthyer mbrapsht, apo shpërndarja e stilolapsave dhe letrave të nxënësit. Mësuesit duhet të kenë parasysh perspektivën e nxënësit për të gjetur mënyrën se si të nxënët e tyre të mund të mbështetët më së miri. Disa fëmijë mund të kenë nevojë të mësojnë më shumë rreth aftësive dhe strategjive vetë-rregulluese, të tjerët mund të kenë nevojë për të përmirësuar strategjitë e tyre të të nxënët. Lista kontrolli të thjeshta dhe listat me këshilla për të nxënët mund t'i ndihmojnë ata të bëhen nxënës më të mirë. Mjetet duhet të jenë të përshtatshme për qëllimin e synuar dhe të lehta në përdorim. Mund të mos jetë gjithmonë e lehtë për mësuesit, prindërit apo nxënësit që të jenë të qartë në lidhje me përparësinë e përdorimit të mjeteve digjitale. Koha e rëndësishme e të nxënët do të shpërdorohej nëse nxënësit do të përdornin materiale të papërshtatshme dhe mjete elektronike që kufizojnë në vend që të zgjerojnë të nxënët.

Si mund të mbështes të nxënët bashkëpunues në distancë?

Të nxënët bashkëpunues është një mjet i fuqishëm për të përmirësuar të nxënët tek të gjithë nxënësit e përfshirë. Ata mund të punojnë së bashku në të njëjtin projekt ose produkt, ndërkohë që përvetësojnë aftësi dhe kompetenca të ndryshme. Në të njëjtën kohë ata përfitojnë nga pikat e forta të nxënësve të tjerë dhe përvetësojnë aftësitë sociale. Se cilat mjete duhen përdorur për të nxënët bashkëpunues, varet nga moshë e

nxënësve dhe disponueshmëria e pajisjeve të komunikimit për të shkëmbyer pyetjet, mendimet dhe për të zhvilluar produktin e tyre.

Si mund të shfrytëzoj më së miri mësimin në distancë dhe mjetet mësimore?

Disa mjete digjitale përdoren lehtësisht, por nuk janë konceptuar për të mbështetur të nxënit kompleks, ndryshe nga mjete të tjera që e mundësojnë këtë gjë, por që janë shumë të vështira për t'u përdorur nga nxënësit pa mbështetje. Një problem tjetër është se në vend që të përdorin një mjet për të mësuar, nxënësit përqendrohen vetëm në mënyrën se si ta menaxhojnë atë. Platformat e të nxënit dhe burimet e informacionit në internet si Ëikipedia, janë mjete potencialisht të shkëlqyera për të mësuar, por që gjithashtu mund të kthehen në pengesa. Mësuesit nuk duhet të supozojnë se nxënësit që dinë të gjejnë informacion në internet, janë gjithashtu në gjendje të përfshihen në përvoja mësimore më të thella në internet. Mësuesve mund t'u kërkohej të investojnë kohë për të zhvilluar njohuritë digjitale, aftësitë për të përdorur në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për të nxënit.

Si mund t'i ndihmoj prindërit që të mbështesin të nxënit efikas?

Prindërit mund të jenë ndihmës të mrekullueshëm për të nxënit, por ata gjithashtu mund të krijojnë barriera të panevojshme. Për shembull, mësimi i fëmijëve përmes metodave që përdoren shumë vite më parë. Prindërit mund të përqendrohen më shumë në përfundimin e detyrave konkrete dhe mund të tregohen të paduruar me fëmijët e tyre kur ata nuk arrijnë nivelet e synuara. Është e rëndësishme të ndahen mendime se si mund të mbështeten më mirë nxënësit dhe t'u ofrohet atyre dhe prindërve metoda ose qasje për të drejtuar dhe vlerësuar të nxënit (për shembull, nëpërmjet ndarjes së përshtypjeve të përshtatshme). Prindërit mund të njihen me mjetet mësimore, metodat e strukturimit dhe mënyrat më efikase për të bërë pyetje. Nëse në familje janë disa fëmijë, prindërit mund të udhëzohen për të krijuar situata kuptimplota të të nxënit që përfshijnë grupmosha të ndryshme të fëmijëve. Sërish, listat e kontrollit ose mjetet e thjeshta mund të jenë të dobishme për prindërit që dëshirojnë të mbështesin fëmijën e tyre, por nuk dinë se si.

PJESA 2: MIRËPRITJA E NXËNËSVE SËRISH NË SHKOLLË

Mirëpritja e nxënësve sërish në shkollë: Analiza e situatës

Situata aktuale për shkak të pandemisë COVID-19 është shoqëruar me një sërë sfidash dhe problematikash të kalimit nga shtëpia në mjedisin shkollor në rrethana komplekse dhe potencialisht kërcënuese. Mësuesit dhe stafet e shkollave e gjejnë veten në një pozitë të vështirë teksa vendet po rihapin shkollat pas izolimit. Ata duhet të mirëpresin të gjithë nxënësit që kthehen në shkollë pa e ditur çfarë kanë përjetuar ata në shtëpi në javët apo muajt e fundit. A kanë marrë të gjithë fëmijët mbështetje emocionale kur ndjeheshin të frikësuar dhe të vetmuar? A mundën ata të mbanin të nxënët në nivelin e nevojshëm për të marrë pjesë sërish në mësimin në klasë? Një tjetër shqetësim është zbatimi i rregulloreve të sigurisë për t'i mbajtur nxënësit të sigurtë dhe për të minimizuar rrezikun ende pjesërisht të panjohur të transmetimit të infeksionit ndërmjet nxënësve dhe nxënësve, dhe nxënësve dhe mësuesve. Për më tepër, shkollat mund të ballafaqohen me prindër që mendojnë se nuk është e sigurtë që të dërgojnë fëmijët e tyre përsëri në shkollë, ndërsa të tjerët janë të mendimit se shkollat nuk po i rikthehen programit të rregullt mësimor aq shpejt sa duhet.

Ndonëse ndërprerja e arsimit formal është një situatë unike për pjesën më të madhe të fëmijëve, për disa është një kërcënim i përhershëm ose një përvojë e përsëritur. Shumë familje të pafavorizuara dhe fëmijë vulnerabël përjetojnë ankth dhe parashikojnë probleme kur mendojnë për arsimin formal. Hendeqet midis jetës në shtëpi dhe jetës shkollore duken të pakapërcyeshme, fëmijët përjetojnë ndjesinë e mënjanimi dhe pasigurisë ndërsa kalojnë në dy botë sociale të largëta. Si familja ashtu dhe mjedisi shkollor nuk janë në gjendje të përçojnë një ndjenjë sigurie; ndjenjën e të qenit të përfshirë në mënyrë efikase ose atë të përkatësisë. Familjet e grupeve vulnerabël, që i përkasin një pakice etnike ose që jetojnë në varfëri mund të mos jenë në gjendje të krijojnë një vlerësim pozitiv për veten që i ndihmon fëmijët të kapërcejnë vështirësitë e përshtatjes sociale. Fëmijët që janë të gatshëm për t'iu përshtatur jetës shkollore dhe për të marrë pjesë në mënyrë aktive në mësim, përballen me mospërputhjet midis kulturës në shtëpi dhe asaj në shkollë, që shpesh çojnë në konflikte identiteti.

Javët dhe muajt e kalimit nga izolimi në procesin e rregullt mësimor në klasë do të jenë plot pasiguri. Askush nuk e di vërtet cila është mënyra më e mirë për t'u ndjekur, cilat praktika janë të sigurt dhe cilat rregullore janë vërtet të nevojshme. Teoritë konspirative, paragjykimet dhe besimet iracionale bëhen prezent dhe nxisin mosbesimin që mund të ketë qenë fshehtas i pranishëm para krizës. Vendimet e marra nga qeveritë dhe autoritetet arsimore vihen në dyshim. Një kulturë mosbesimi, tjetërsimi dhe përjashtimi kërcënon marrëdhëniet midis prindërve, mësuesve dhe nxënësve. Kriza ka përkeqësuar shumë situatën dhe ka rritur sfidat me të cilat

mësuesit dhe prindërit po luftojnë tashmë, për shembull mungesa e mbështetjes së përshtatshme ose pamundësia e nxënësve për t'u vetë-menaxhuar. Falë krizës mund të shfaqet ndjenja e fshehtë e dështimit dhe e pamundësisë për të siguruar burimet e nevojshme për mësim.

Kriza aktuale COVID-19 mund të jetë një kërcënim serioz për arsimin cilësor për të gjithë fëmijët, por është gjithashtu një mundësi. Kriza ka evidentuar nevojën për bashkëpunim dhe koordinim midis institucionit dhe individëve. Ne kemi kuptuar që të gjithë duhet të marrim përgjegjësi për sjelljen tonë dhe të respektojmë nevojat e sigurisë së të tjerëve dhe se të mësuarit nuk është vetëm një proces njohës, por edhe një proces shoqëror.

Prindërit, nxënësit dhe mësuesit mund të ndjehen në faj që nuk kanë qenë të aftë të përmbushin detyrat e tyre ose të përmbushin idealet e tyre. Është e thjeshtë t'ia hedhësh fajin dikujt tjetër kur gjërat shkojnë keq. Por të gjithë ne tani mund të zgjedhim të përpiqemi të kuptojmë realitetin shoqëror të tjetrit, ta respektojmë atë dhe të ndërtojmë ura ndërmjet shtëpisë dhe shkollës, midis asaj që ishte dhe çfarë do të jetë. Ka disa çështje kyçe që duhen adresuar dhe zgjidhur në fazën kalimtare midis izolimit dhe rikthimit në mësimin e rregullt në klasë:

- Duhet të forcohet partneriteti midis shtëpisë dhe shkollës.
- Përvojat dhe ndjenjat e ndryshme rreth kthimit në shkollë duhet të jenë të përmbajtura.
- Pjesëmarrja, ndjenja e përkatësisë dhe rivendosja e marrëdhënieve duhet të sigurohen para se fëmijët të jenë të gatshëm të mësojnë përsëri në klasa.

Ministritë, autoritetet vendore dhe mësuesit janë nën presion për të vlerësuar mangësitë dhe boshllëqet e të nxënësve. Punëdhënësit e ardhshëm dhe institucionet e arsimit të lartë janë të shqetësuar se nxënësit nuk do të përmbushin standardet e tyre të cilësisë për shkak të humbjes së mundësive të të nxënësve gjatë krizës së COVID-19. Nëse është e mundur, nxitja për të testuar fëmijët duhet të jetë sa më e kufizuar, të paktën për nxënësit në moshë të vogël dhe ata vulnerabël.

Përpara testimit, nxënësit duhet të mirëprehen në shkollë dhe duhet të rivendoset ndjesia e përkatësisë dhe pjesëmarrjes.

Mirëpritja e nxënësve sërish në shkollë: Çështjet dhe pyetjet kyçe

Të kuptojmë situatën e nxënësve jashtë shkollës duke u përqendruar te nxënësit (KUSH?)

Pyetjet kryesore:

- A e di unë çfarë kanë përjetuar nxënësit e mi gjatë izolimit?
- Si t'i përgatis nxënësit për rikthimin në shkollë?
- A janë nxënësit e mi gati për të nxënë sërish në klasa?

Periudhat e kalimit nga shtëpia në shkollë janë shumë të rëndësishme për mirëqenien e nxënësve dhe aftësinë e tyre për t'u angazhuar plotësisht. Mospërputhja midis përvojave në shtëpi dhe atyre në shkollë është e vështirë të kapërcehet edhe në rrethanat më të mira. Mësuesit duhet të jenë të përgatitur për të menaxhuar një gamë të gjerë emocionesh që nga lumturia dhe lehtësimi për t'u rikthyer në klasë, tek ankthi, dëshpërimi dhe faji. Disa fëmijë mund të druhen nga pyetjet e mësuesve ose të bashkëmoshatarëve se si e kanë kaluar kohën e tyre. Disa fëmijë mund të mos kenë lëvizur shumë gjatë periudhës së izolimit; disa mund të kenë ngrënë shumë, disa mund të kenë kaluar përvoja traumatike.

Fëmijët më të vegjël në moshë mund të mos e kenë kuptuar plotësisht pse u ndalohej të takonin njerëzit e dashur dhe aktivitetet në natyrë. Sfidat kryesore tani nuk është të vlerësojmë të nxënësit dhe të kategorizojmë fëmijët në nxënës të suksesshëm dhe të dështuar, por së pari të sigurojmë që të gjithë fëmijët të ndjehen të mirëpritur dhe të vlerësuar pavarësisht nga çfarë mësuan apo nuk mësuan gjatë izolimit. Pyetjet e mëposhtme do t'ju ndihmojnë të arrini këtë:

Si të identifikoj fëmijët në rrezik për të mos u kthyer në shkollë?

Parashikimi se disa nxënës do të përballen me vështirësi është një pjesë e rëndësishme e përgatitjes për të mirëpritur fëmijët në shkollë. Fëmijët vulnerabël dhe fëmijët që kishin vështirësi me të nxënësit përpara izolimit do të jenë në rrezik për të mos u kthyer në shkollë, qoftë fizikisht, emocionalisht ose të dyja. Është e rëndësishme, veçanërisht për fëmijët e cënueshëm dhe familjet e tyre që të bëhen të mundura përvoja pozitive kalimi. Mësuesit mund të kenë nevojë të fillojnë procesin e kalimit disa javë para ditës së parë të rikthimit në shkollë. Mund të jetë e rëndësishme të bëhet jo vetëm një vlerësim i nevojave, por edhe një vlerësim i rrezikut për të kuptuar situatën e fëmijëve vulnerabël.

Si të përfshij fëmijët dhe familjet në procesin e kalimit?

Familjet do të kenë kaluar shumë javë së bashku me fëmijët e tyre kur shkollat të hapen përsëri. Ata mund të jenë duke pritur me padurim që t'i dërgojnë fëmijët e tyre përsëri në shkollë, ose mund të kenë frikë se mos fëmija i tyre do të ekspozohet ndaj një rreziku të panevojshëm. Ata mund të planifikojnë të mos e dërgojnë fëmijën e tyre përsëri në shkollë, ose mund të hasin në vështirësi logjistike nëse shkollat fillojnë me një regjim gjysmë ditor për t'i mbajtur grupet e fëmijëve të vogla. Procesi i kalimit kërkon përgatitje, transferim, induksion dhe konsolidim. Miratimi i një përjasjeje të përqendruar te fëmijët do të ndihmojë familjet të vendosin interesat më të larta të fëmijës së tyre në qendër dhe të zhvillojnë një vizion dhe strategji të përbashkët me shkollën.

Si mund të mirëpres pa asnjë mëdyshje të gjithë fëmijët që kthehen në shkollë?

Fëmijët vulnerabël janë në rrezik të braktisjes së shkollës ose të mbeten pas,

veçanërisht nëse shkollat ndërmarrin vlerësime të performancës së nxënësve. Testimi mund të bëhet me qëllimin e mirë për të identifikuar fëmijët që kanë mbetur pas në mësim, por fëmijët që nuk përmbushin pritshmëritë do të ndjehen të refuzuar. Fëmijët së pari duhet të ndjehen të pranuar, të ndjejnë se iu njihen vlerat dhe të respektohen thjesht për ata që janë dhe jo për aftësinë për të pasur një performancë të lartë. Ndjesia pozitive për identitetin vetjak është e nevojshme për t'u angazhuar në procesin e të nxënësve. Mësuesit nuk duhet të duan të gjithë nxënësit e tyre, por ama duhet t'i respektojnë ata. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të zhvillojnë talentin dhe potencialet e tyre - pavarësisht nëse ato plotësojnë pritshmëritë e mësuesve për një nxënës të mirë apo jo.

Si t'i ndihmoj nxënësit të menaxhojnë pasiguritë?

Nxënësit mund të kenë përjetuar shumë pasiguri gjatë izolimit dhe mund të jenë përballur me stres, sëmundje apo edhe vdekjen e njerëzve të dashur. Duke mos ditur se çfarë i pret, ata mund të kenë frikë të kthehen në shkollë, veçanërisht nëse do të duhej të vendoseshin masa sigurie. Ata mund të kenë shumë pyetje, por mund edhe të mos duan të flasin për ndjenjat e tyre. Ata thjesht duan t'i kthehen jetës shkollore me të cilën ishin mësuar përpara krizës. Disa nxënës mund të shprehin pasiguri të tyre nëpërmjet zemërimit dhe agresionit, ndërsa të tjerë mund të bëhen më të tërhequr. Mësuesit duhet të përgatiten për reagimet e ndryshme duke parashikuar vështirësitë dhe duke planifikuar më parë, duke qëndruar të qetë dhe duke përcjellë vetëbesim, qartësi dhe qetësi në momentet që nxënësit e tyre kanë më shumë nevojë. Mësuesit mund të ndihmojnë nxënësit të përqendrohen në ato që mund të kontrollojnë në vend të asaj që nuk mund të kontrollojnë.

Si të parandaloj mosangazhimin?

Për disa nxënës, sfidat me të cilat përballen kur kthehen në shkollë mund të duken pothuajse të pakapërcyeshme. Me kthimin në klasë kthehen sërish konfliktet me nxënësit e tjerë, dallimet në performancë ose frika e dështimit. Fëmijët mund të ndjejnë vështirësitë e tejkalimit të pritshmërive kontradiktore nga prindërit dhe mësuesit ose një ndjesi të përgjithshme të të qenit të pafuqishëm. Ndjesia se gjithçka mbetet e njëjtë dhe se asgjë nuk mund të bëhet për ta bërë arsimin më kuptimplotë do t'i lërë vend sjelljes së keqe, mungesave të pajustificuara dhe performancës së ulët. Çelësi për sigurimin e angazhimit është motivimi i brendshëm. Nxënësit duhet të ndiejnë se kanë një farë kontrolli mbi atë çka bëjnë (autonomi), duhet të ndjehen të aftë të përfundojnë një detyrë me sukses (kompetencë) dhe duhet të ndjehen të lidhur dhe të dashur nga të tjerët (të qenit i lidhur). Por me e rëndësishmja, ata duhet ta konceptojnë atë që bëjnë si interesante ose që ka një qëllim të caktuar.

Shfrytëzimi i potencialit të lidershit të nxënësve është një mënyrë efikase për t'i shndërruar ata nga konsumatorë pasivë dhe të paangazhuar, në pjesëtarë aktivë në një komunitet mësues.

Sigurimi i pjesëmarrjes së nxënësve që kthehen në shkollë duke u përqendruar në qëllimin e të nxënës (PSE)?

Pyetjet kryesore:

- A dinë nxënësit e mi si të jenë të sigurtë në mjedisin shkollor?
- Cilët janë rezultatet më të rëndësishme për nxënësit në javët e para të kthimit në shkollë?
- Si mund t'i ndihmoj të gjithë nxënësit të jenë të aftë të nxënë?

Të jesh pjesë e arsimit do të thotë të jesh i angazhuar nga ana emocionale, njohëse dhe e sjelljes në të nxënës kuptimplotë. Pas javësh shkëputje nga jeta shkollore, pjesa më e madhe e fëmijëve mund të duan të kthehen te rutinat e tyre të mëparshme, të takojnë miqtë dhe të shijojnë veprimtaritë e tyre të preferuara shkollore. Edhe mësuesit do të ndjehen njëloj. Edhe mësuesve edhe nxënësve do t'iu duket mjedisi shkollor i ndryshuar, rutinat të prishura dhe miqësitë sikur kanë ndryshuar për shkak të kufizimeve të vendosura gjatë izolimit e më pas.

Disa nxënës ndoshta mezi prisnin të ktheheshin në shkollë, ndërsa të tjerë do të donin të mos ishin kthyer kurrë. Në vend që të përqendrohemi në të nxënës akademik dhe të bëni përpara për të arritur synimet e vendosura në kurrikul, do të ishte më me vlerë të shpenzoni kohë për të arritur pjesëmarrje të plotë të të gjithë fëmijëve. Fëmijët mund të kenë përjetuar kriza ose mund të jenë ekspozuar ndaj dhunës dhe fillimisht duhet të ndjehen të sigurtë dhe të mirëpritur. Të tjerë mund ta kenë shijuar autonominë dhe të bezdisen nga kufizimet që u janë vendosur në klasë. Fëmijët do të kenë përvetësuar ritmin e tyre të të nxënës dhe do të kenë ndjekur programin e tyre. Do të duhet pak kohë për të bërë së bashku të gjitha këto përvoja dhe ky duhet të jetë objektivi kryesor në ditët e javët pas kthimit në shkollë. Pyetjet e mëposhtme mund të ndihmojnë në sigurimin e pjesëmarrjes si qëllimin e parë për të arritur:

Si t'i bëj fëmijët të ndjehen të sigurtë dhe të mirëpritur?

Sidomos në periudhat e pasigurta pas izolimit, është e rëndësishme që fëmijët të ndjehen të sigurtë dhe të mirëpritur. Rregullat e reja, mënyrat e ndryshme të bashkëveprimit dhe kufizimet mbi lirinë personale mund të bëjnë që fëmijët të ndjehen si të huaj me mësuesit dhe bashkëmoshatarët e tyre. Duke reflektuar mbi tre elementët e pjesëmarrjes (përkatësia, autonomia, kompetenca), mësuesit duhet të sigurojnë që nxënësit të kenë mundësi të shprehin frikërat e tyre, të zhvillojnë një ndjenjë autonomie në përshtatjen me situatën e re dhe të dinë se si duhet të sillen për të respektuar rregullat e reja. Mund të lindë nevoja për krijimin e grupeve më të vogla të fëmijëve për të përmbushur rregulloret e sigurisë në lidhje me COVID-19. Nxënësit mund të kenë frikë se mos infektohen dhe se mos padashur ua transmetojnë sëmundjen pjesëtarëve të familjes që janë më të rrezikuar. Mirëpritja e nxënësve sërish në shkollë duhet të trajtohet dhe të mbahet mend si një përvojë e pëlqyeshme. Komunikimi i rregullave të reja duhet të ketë frymën e "ne mund ta bëjmë këtë së

bashku për të gjithë ne" Mësuesit duhet të jenë të kujdesshëm ndaj shenjave joverbale për të identifikuar fëmijët që nuk ndjehen të sigurtë në klasë.

Si të siguroj pjesëmarrjen pas kthimit në klasë?

Pasi nxënësit të ndjehen të qetë dhe të sigurtë, përmirësimi i pjesëmarrjes duhet të jetë qëllimi dhe objektivi kryesor i mësuesve. Ndjenja e kompetencës forcohet nëpërmjet udhëzimeve të qarta, pritshmërive të qarta dhe informimit qartë të pasojave. Mësuesit duhet të sigurohen që fëmijët të dinë se mangësitë e tyre në mësim nuk çojnë në përjashtimin e tyre nga mësimi në klasë, përkundrazi, do të bëhen përpjekje shtesë nga të gjithë që asnjë fëmijë të mos mbetet mbrapa. Disa nxënës mund të kenë nevojë për më shumë udhëzime në strukturimin e detyrave komplekse ndërsa të tjerët do të kenë nevojë për më shumë autonomi për të eksploruar mënyrat e tyre të të nxënësve.

Krijimi i mundësive që nxënësit të drejtojnë veprimtari, të sjellin interesat e tyre dhe krijimi i mundësive që ata të marrin përgjegjësi për të nxënësit e tyre dhe të nxënësit bashkëmoshatarëve të tyre ndihmon në përmirësimin e pjesëmarrjes së nxënësve. Ndjesia e përkatësisë ose krijimi i lidhjeve arrihet duke angazhuar nxënësit emocionalisht dhe duke vlerësuar kontributet e tyre. Të lidhesh si mësues me atë çfarë fëmijët dhe familjet e tyre vlerësojnë është një pikë e rëndësishme hyrëse për të zgjeruar aftësitë e fëmijës.

Si të sigurohem që të gjithë fëmijët po nxënë me vetëbesim?

Mësuesit që kanë vetëbesim i ndihmojnë nxënësit të ndërtojnë vetëbesimin e tyre. Mësuesit që besojnë në aftësinë e tyre për të arritur dhe mësuar të gjithë fëmijët janë një model i rëndësishëm për fëmijët që mund të kenë humbur besimin dhe nuk besojnë më në aftësinë e tyre për të nxënë. Reagime të rregullta që vlerësojnë punën dhe veprimtarinë e nxënësve në vend të vetë nxënësve ofrojnë një drejtim të nevojshëm për të pasur vetëbesim. Vendosja e pritshmërive të arritshme, por sfiduese, i nxit nxënësit të ecin përpara në rrugën e tyre të të nxënësit. Nxënësit që kanë mbetur pas me mësimet e tyre mund të ndjehen të dekurajuar kur krahasojnë veten me nxënësit e tjerë. Objektivat personale të të nxënësit kuptimplotë për nxënësit do t'i ndihmojnë ata të përqendrohen tek të nxënësit në vend që të krahasojnë veten me të tjerët. Angazhimi i nxënësve në të nxënësit në mënyrë që të krijojnë një koncept pozitiv për veten është parakushti për vetëbesim.

Si të ndihmoj fëmijët që të përjetojnë vazhdimësinë e të nxënësit?

Kriza COVID-19 ose ndonjë ngjarje tjetër që rezulton në mungesë të zgjatur të nxënësve, rrezikon të ndërpresë të nxënësit. Pasi të kthehen në shkollë, nxënësit mund të shpërqendrohen apo përballen me vështirësi për t'u përshtatur me të nxënësit në klasë. Mësuesit mund t'i ndihmojnë nxënësit të përvetësojnë një perspektivë më të gjerë duke nxjerrë në pah raste nga muajt para mungesës dhe të kujtojnë nxënësit për gjithçka kanë mësuar dhe përjetuar së bashku. Mësuesit mund të përdorin mjete

vizuale, si vizatime ose harta të mendjes, për ta vendosur krizën në perspektivë të karrierës shkollore të nxënësve, për të bërë të mundur që ata të shikojnë përpara dhe të ndjehen të sigurtë në të nxënit e tyre. Mësuesit mund të sugjerojnë që nxënësit të imagjinojnë veten pas dy vitesh teksa shikojnë pas në të tashmen, për të përjetuar vazhdimësinë e të nxënit.

Si mund të rikrijoj një komunitet nxënësish?

Të nxënit është një proces social që kërkon pjesëmarrjen aktive të çdo nxënësi. Kriza e COVID-19 ka shkëputur marrëdhëniet midis nxënësve. Mësuesit duhet të planifikojnë kremtimin e të qenit sërish së bashku dhe të investojnë në krijimin e marrëdhënieve, sigurisht duke respektuar kufizimet e vendosura. Rikthimi i nxënësve në shkollë është koha më e mirë për të nxitur komunitetet e të nxënit dhe për të filluar një qasje të re ndaj të nxënit, si një përvojë pjesëmarrëse, ku bashkëpunimit ndërmjet nxënësve i jepet një prioritet më i madh. Puna në bashkëpunim mund të jetë një motiv i fortë që nxënësit të arrijnë rezultate më të mira. Për më tepër, kjo u jep mësuesve kohën e vlefshme për të siguruar mbështetje për nxënësit që kanë nevojë për vëmendje të veçantë.

Përdorimi i përvojave të nxënësve si pikë fillestare për të nxënit duke u përqendruar te të nxënit (ÇFARË?)

Pyetjet kryesore:

- Te cilat kompetenca duhet të përqendrohem më parë?
- Si mund të sigurohem për vazhdimësinë e të nxënit?
- Si mund të zbuloj nivelin e të nxënit të nxënësve?

Mësuesit mund të tundohen nga ideja e të përqendruarit direkt te mësimi sipas kurrikulës dhe të përpiqen të ecin me programin mësimor për të siguruar rezultate të mira. Një strategji e tillë ka të ngjarë të bëjë që një pjesë e madhe e nxënësve të ndjehen të mbingarkuar, sikur nuk kanë aftësitë e nevojshme dhe të jenë frikësuar për të ardhmen e tyre. Ndonëse nuk është plotësisht në autoritetin e mësuesve të vendosin kur nxënësit kthehen në shkollë, si të adresojnë përvojat traumatike, ose të miratojnë rregullat dhe rregulloret e reja, mësuesit duhet të përpiqen të plotësojnë nevojat e nxënësve sa më shumë të jetë e mundur. Nxënësit kanë tërë jetën e tyre përpara për të kompensuar atë që kanë humbur në muajt e fundit, por nëse këto boshllëqe do të trajtohen si probleme, nxënësit do të ndjehen të pafuqishëm. Pasiguria e kualifikimit duhet të adresohet, por duke pasur interesat më të larta të nxënësve në qendër të të gjitha konsideratave. Përqendrimi në zgjidhjen e konflikteve, forcimin e reziliencës emocionale dhe sigurimin e pjesëmarrjes duhet të jetë në qendër të mësimdhënies kur nxënësit të kthehen në klasë. Pyetja e mëposhtme përpiket të adresojë çështjet më të rëndësishme rreth çfarë duhet t'iu mësoni së pari:

Si mund t'i mësoj për rregullat e reja të sigurisë?

Mësuesit nuk do të duhet të përshtaten vetëm me mjedisin në klasë dhe rutinat, ata gjithashtu duhet të mësojnë nxënësit se si të ndryshojnë sjelljen e tyre për t'i mbajtur të gjithë të sigurtë. Veçanërisht nxënësit më të vegjël do ta kenë shumë të vështirë të mbajnë distancën e nevojshme për miqtë e tyre dhe të mbajnë mend rutinat e reja. Prindërit mund të ndjehen në ankth për dërgimin e fëmijëve të tyre përsëri në shkollë, prandaj është e rëndësishme të informoni prindërit dhe fëmijët për masat e sigurisë të vendosura dhe të shpjegoni arsyetimin për ndryshimet e zbatuara në rutinat e shkollës. Masat e sigurisë për të mbajtur të gjithë të sigurtë janë vendosur; theksi duhet të jetë në përgjegjësinë kolektive për mirëqenien e të gjithëve. Nxënësit duhet të inkurajohen të bëjnë pyetje dhe mësuesit duhet të përgjigjen sa më mirë që të jetë e mundur, dhe të tregojnë qartë se për çfarë nuk ka ende njohuri të disponueshme. Kriza COVID-19 është një mundësi për të nxitur një qasje kureshtare dhe eksperimentale ndaj problemeve dhe për të ilustruar krijimin e njohurive duke sjellë përvoja nga njerëz të ndryshëm dhe vende të ndryshme.

Si mund të forcoj aftësitë emocionale dhe reziliencën e nxënësve të mi?

Kompetenca emocionale është thelbësore për suksesin e të nxënësve në klasë. Bëhet fjalë për aftësinë për të njohur, kuptuar dhe reaguar ndaj emocioneve të vetvetes dhe të tjerëve. Vetë-rregullimi i emocioneve është një element kryesor i të nxënësve të suksesshëm. Të marrësh në konsideratë perspektivën e të tjerëve ndihmon në krijimin e empatisë dhe respektit. Fëmijët vulnerabël janë në rrezik më të lartë për të mos qenë në gjendje të shprehin, të tejkalojnë ngjarjet traumatike ose të menaxhojnë stresin e përjetuar në shkollë dhe në shtëpi. Nxitja e emocioneve pozitive duke krijuar një ndjesi krenarie dhe përkatësie brenda shkollës mund të ndihmojë në kapërcimin e situatave të vështira në shtëpi.

Si të mbështes nxënësit që të ndajnë përvojat e tyre të mosqenies në shkollë?

Për vazhdimësinë e mësimi është e rëndësishme të reflektoni mbi përvojat e fëmijëve gjatë izolimit dhe të siguroheni që nxënësit të kuptojnë plotësisht arsyet e mbylljes së shkollave. Duke inkurajuar nxënësit të ndajnë përvojat e tyre, ata përfshihen në vetë-reflektim mbi çka i ndihmoi ata të nxënë dhe në cilat situata ishte i vështirë të nxënit. Mësuesit mund t'i ndihmojnë nxënësit të bëjnë paqe me periudhat e vështira, ndërsa vlerësojnë përvojat e mira dhe mësojnë prej tyre për të ardhmen. Nxënësit duhet të dinë më shumë rreth asaj që kanë përjetuar dhe kjo mund të jetë një mundësi e shkëlqyer për t'i motivuar dhe për t'i inkurajuar ata të vazhdojnë të nxënë. Duke shkëmbyer përvojat e tyre dhe mënyrat se si kapërcyen pasiguritë dhe paqartësitë e tyre, mësuesit dhe prindërit mund të bëhen modele të fuqishme për t'u ndjekur.

Si mund të vlerësoj gjendjen e të nxënësve të mi?

Mësuesit duhet të dinë se çfarë kanë ose nuk kanë mësuar nxënësit e tyre gjatë

izolimit. Vlerësimi i të nxënit është më i gjerë se testimi i nxënësve sipas standardeve të performancës. Në vend që të përqendrohet në ato që nxënësit nuk kanë nxënë, praktika e vlerësimit duhet të përqendrohet në ato që ata kanë nxënë. Vlerësimi i të nxënit duhet të shkojë përtej përmbajtjes së kurrikulës për të vlerësuar atë çfarë nxënësit kanë nxënë. Për më tepër, vëmendja duhet të jetë në çfarë nxënësit duhet të nxënë më tej, jo në çfarë kanë apo nuk kanë nxënë ata. Reflektimi mbi të nxënit së bashku me nxënës të tjerë ndihmon në identifikimin e mënyrës më të mirë për të ecur përpara. Vëmendja duhet të jetë te kompetencat për të zgjidhur problemet reale jo në marrjen e përgjigjes së duhur; kjo përfshin kompetencat ndërkurrikulare, kompetencat që mbështesin të nxënit, si zakonet e të nxënit, aftësitë vetë-rregulluese ose aftësitë e komunikimit. Për më tepër, nxënësit mund të kenë zhvilluar qasje krijuese ndaj të nxënit duke përdorur mjedise mësimore digjitale ose burime digjitale të tjera.

Si mund të përmirësoj të nxënit e nxënësve duke marrë parasysh ndryshimet e mëdha ndërmjet tyre?

Mësimi tradicional në klasë është ndërtuar mbi supozimin se të gjithë nxënësit përvetësojnë të gjitha aftësitë me të njëjtën shpejtësi dhe në të njëjtën kohë. Me këto pritshmëri, mësuesit do ta kenë të vështirë të përshtaten me larminë e rritur të aftësive, stileve të të nxënit dhe preferencave për t'u përfshirë në mësim. Mësuesit mund të përpiqen të nxjerrin në pah problemet që kanë disa nxënës në veçanti, duke shpenzuar kështu kohë të vlefshme që mund të investohej më mirë në procesin e të nxënit. Grupe të ndryshme të nxënësve kanë një potencial të lartë për të krijuar njohuri të reja dhe kuptim më të thellë. Gabimet ofrojnë mundësi të vlefshme për të zhvilluar një kuptim më të thellë dhe për të zhvilluar të menduarit kritik. Çdo nxënës ka pikat e tij të forta dhe talentet që mund të kthen në nxitës të fuqishëm të të nxënit. Për të zbuluar këtë potencial, nevojitet një kuptim më i thellë i aftësisë së nxënësit se sa të dhënat e gjeneruara nga testet e performancës. Për të menaxhuar grupe të ndryshme mësimore, mësuesit duhet të jenë të gatshëm dhe të aftë të krijojnë mundësi mësimore të pasura, angazhuese dhe motivuese për të gjithë nxënësit, jo vetëm për 20 për qind të nxënësve më të mirë.

Si mund të ndihmoj nxënësit të përqendrohen te mësimi i bazuar në kurrikul?

Nuk ka rrugë të shkurtër për mësimin e bazuar në kurrikul, nëse nuk janë adresuar nevojat mësimore bazë. Fëmijët duhet të inkurajohen të angazhohen në veprimtari mësimore që janë kuptimplota për ta. Për shembull, kompetencat në matematikë mund të zhvillohen duke analizuar rezultatet e garave me kuaj ose rezultatet e ndeshjeve të futbollit ashtu si dhe duke bërë detyrat e matematikës në fletën e punës së përgatitur nga mësuesi. Mësuesit e mirë janë në gjendje të kuptojnë thelbin e asaj që duhet të mësohet dhe ta paraqesin problemin në mënyrën që nxënësit mund ta njohin. Për më tepër, nxënësit mund të jenë përfshirë në veprimtari mjaft komplekse për zgjidhjen e problemeve gjatë izolimit, pa kuptuar lidhjet me objektivat në kurrikul. Përgatitja e një vakti të ndërlikuar, ndërmjetësimi i një grindjeje mes vëllezërve dhe

motrave ose mos heqja dorë nga një projekt si plotësimi i një lojë formuese pazëll me 1500 pjesë janë arritje të mëdha që mund të lidhen lehtësisht me kompetencat e përcaktuara në kurrikul. Evidentimi dhe vlerësimi i këtyre arritjeve është njohje e të nxënësve dhe duhet të përdoret si baza mbi të cilën të ngrihet të nxënësve në të ardhmen.

Si mund të vazhdoj të mbështes zhvillimin e aftësive digjitale?

Nxënësve do të kenë pasur shumë mundësi të përdorin mediat elektronike dhe mjetet digjitale teksa ishin në shtëpi. Aftësia për të përdorur këto mjete nuk duhet të ngatërrohet me kompetencën digjitale. Aftësi digjitale do të thotë aftësia për të përdorur teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për të gjetur, vlerësuar dhe komunikuar informacion dhe njohuri. Kjo kërkon aftësi teknike, njohëse, emocionale dhe sociale. Aftësi të përparura digjitale do të thotë edhe që nxënësve janë të aftë të përdorin mjediset komplekse mësimore online për të përmirësuar të nxënësve dhe kuptimin e tyre. Në nivel ndërkombëtar, ekzistojnë disa korniza kompetencash që mund të përdoren për të vlerësuar dhe promovuar aftësinë digjitale, ose një kornizë e tillë mund të ekzistojë gjithashtu në shkallë vendi ose shkolle.

Kalimi nga mjediset e shtëpisë në ato të shkollës duke u përqendruar të konteksti mësimor (KU?)

Pyetjet kryesore:

- Si mund t'i ndihmoj nxënësve të ndjehen të mirëpritur në mjedisin shkollor, pavarësisht shqetësimeve lidhur me sigurinë?
- Si mund të përfitojë projektimi i klasës nga mjediset efektive mësimore në shtëpi?
- Si mund të zhvilloj mjedise mësimore bashkëpunuese?

Gjatë izolimit, mësuesit, prindërit dhe nxënësve u detyruan të shqyrtojnë, përdorin ose zhvillojnë mjedise mësimore të reja. Hapësirat mësimore u zgjeruan në shtëpi, në lagje, në hapësira kibernetike, në varësi të rregulloreve specifike të izolimit për vendin. Janë zbuluar mjedise të reja mësimore, disa prej të cilave mund të jenë më tërheqëse dhe më mbështetëse për të nxënësve e vetë-drejtuar, sesa klasat tradicionale. Mësuesit, nxënësve dhe prindërit u detyruan të hulumtojnë mbi mënyra të reja të strukturimit të të nxënësve

dhe ndërveprimit me njëri-tjetrin. Disa fëmijë madje mund të kenë përparuar në shkollimin në shtëpi dhe kanë përfituar nga mjediset mësimore të përshtatura për nevojat e tyre specifike, ndërsa të tjerët mund të kenë përjetuar vështirësi në të nxënësve në një mjedis çrregullues ose madje dhe armiqësor. Mësuesit duhet të përpiqen të ndërthurin "më të mirat e dy botëve" dhe në këtë mënyrë të lehtësojnë kalimin nga shtëpia në mjediset shkollore. Pyetjet e mëposhtme mund të ndihmojnë mësuesit të

adresojnë çështjet kyçe:

Si të sigurohem që është e sigurtë për fëmijët që të kthehen në shkollën dhe në klasën ku punoj?

Mësuesit dhe shkollat duhet të përgatisin rihapjen e shkollave paraprakisht për të siguruar që ata janë në gjendje të krijojnë një mjedis të sigurtë për nxënësit dhe mësuesit. Nevojitet një qasje mbarë-shkollore për të zhvilluar një sërë rregullash dhe përshtatjesh koherente për të zbatuar rregulloret e sigurisë. Disa mësues dhe nxënës mund të jenë pjesë e grupit me rrezik të lartë dhe do të kenë nevojë për mbrojtje të veçantë. Duhet të hartohet një kornizë gjithëpërfshirëse e mbrojtjes që merr në konsideratë të gjitha hapësirat dhe veprimtaritë.

Rregullat dhe përshtatjet duhet të jenë të arsyeshme dhe të zbatueshme, dhe fëmijët duhet të jenë në gjendje t'i kuptojnë ato. Fëmijët vulnerabël mund të kenë nevojë për vëmendje të veçantë, për shembull nxënësve që u jepet ushqim nga shkolla, ata që përdorin shërbimet e transportit ose ata që janë në rrezik të lartë për të rënë pre e bullizmit. Pasi nxënësit të kthehen në shkollë, është e rëndësishme të siguroheni që fëmijët të kuptojnë, të jenë në gjendje dhe të jenë të gatshëm të ndjekin rutinat e reja.

Si mund t'i ndihmoj fëmijët në kalimin nga mjedisi i shtëpisë në mjedisin shkollor?

Nxënësit mund të kenë kaluar javë të tëra në shtëpi duke pasur shumë pak kontakt me botën e jashtme. Në rastet më të mira, mësuesit ishin në kontakt të vazhdueshëm me familjet dhe fëmijët, duke u siguruar që fëmijët të nxënë dhe të mos ndihen të mbingarkuar ose të izoluar. Nëse për cilëndo arsye mësuesit kanë humbur kontaktin me disa nga nxënësit e tyre, kjo duhet adresuar përpara se nxënësit të kthehen në shkollë. Mësuesit dhe prindërit duhet të diskutojnë për vështirësitë e mundshme me të cilat mund të haset fëmija dhe mësuesit mund të fillojnë kontaktin nxënës-nxënës nëse është e mundur ndërkohë që nxënësit janë ende në shtëpi. Duhet diskutuar ndërprerja midis të nxënësve në shtëpi dhe në klasë, si dhe mënyrat e rifillimit të të nxënësve në klasë. Disa vende mund të fillojnë me grupe më të vogla, me dy turne ose duke përdorur hapësira të reja mësimore në përputhje me rregulloret. Kjo mund të krijojë probleme shtesë për prindërit me fëmijë që ndjekin mësimin në turne të ndryshme. Shkollat duhet të ofrojnë kujdesin e fëmijëve duke mbuluar orët e zakonshme mësimore për të lehtësuar situatën e prindërve që duhet të kthehen në punë.

Si mund të krijoj ekosisteme mësimore që arrijnë nxënësit përtej mureve të klasës?

Mësimi në shtëpi mund të ketë qenë një përvojë sfiduese për prindërit, të cilët tashmë e vlerësojnë më shumë punën profesionale të mësuesve. Prindërit mund të kenë arritur të kuptojnë zakonet e të nxënësve të fëmijëve të tyre. Nga ana tjetër disa mësues, mund të jenë përballur me qëndrimin në shtëpi me fëmijët e tyre dhe përjetimin e vështirësive të të nxënësve në shtëpi. Veprimtaritë ekstra-kurrikulare kanë rezultuar të jenë mundësi të suksesshme të të nxënësve dhe të kuptuarit e prindërve dhe mësuesve është thelluar në javët larg klasës. Mjediset mësimore digjitale dhe kanalet e

komunikimit digjital tani mund të jenë të gatshme për t'u përdorur në një ekosistem mësimor që arrin përtej klasës. Ky ekosistem i ri i të nxënësve dhe komunikimit duhet të mirëmbahet dhe kultivohet si një mënyrë për të pasuruar mësimin në klasë. Mësuesit mund të përdorin këto përvoja për të ndërtuar partneritete të reja ose më të forta me prindërit dhe me sistemet mbështetëse shtesë, p.sh. qendrat e burimeve ose specialistët për të krijuar një mjedis mësimor koherent për të gjithë nxënësit.

Si mund të mbështes kalimin nga mjedisi mësimor digjital në atë të klasës?

Mësimi digjital dhe përdorimi i kompjuterëve, televizionit ose mediave të tjera është në përgjithësi tërheqëse për nxënësit. Për fëmijët me probleme të dëgjimit ose probleme të vëmendjes, të nxënësve të personalizuar me pajisje të përshtatura mund të ketë qenë edhe më i suksesshëm sesa metodat tradicionale të mësimdhënies. Disa nxënës mund ta kenë të vështirë të lënë pas botën digjitale dhe të kthehen në klasë. Në vend që ta shohin këtë si problem, mësuesit duhet ta shfrytëzojnë këtë mundësi dhe të mësojnë më shumë rreth asaj çfarë funksionon për të cilin nxënës dhe si mësimi digjital mund të pasurojë praktikën në klasë. Nxënësi mund të ftohen në një seancë me shfaqje dhe tregime ku të sjellin pajisjet e tyre dhe t'u shpjegojnë nxënësve të tjerë dhe mësuesve se çfarë funksionoi për ta (ose nuk funksionoi), çfarë u pëlqeu veçanërisht në përdorimin e këtyre pajisjeve dhe ku gjetën burimet më të dobishme të të nxënësve në botën digjitale. Mësuesit duhet të diskutojnë me nxënësit për strategjitë e suksesshme për përzgjedhjen e informacionit, fitimin e njohurive, vlerësimin e cilësisë së informacionit dhe përdorimin e burimeve online për të nxënë. Praktikën e mira të zhvilluara nga nxënësit duhet të zbatohen edhe në klasë.

Si mund të nxis një klimë bashkëpunuese të të nxënësve në klasën time?

Një përvojë që pjesa më e madhe e nxënësve do të ketë humbur gjatë javëve në shtëpi është bashkëveprimi dhe bashkëpunimi me mësuesin e tyre dhe nxënësit e tjerë. Pavarësisht masave të sigurisë dhe distancimit fizik që duhet të respektohet gjatë javëve ose muajve të ardhshëm, nxënësit duhet të inkurajohen të mësojnë nga njëri-tjetri, të zhvillojnë marrëdhënie pozitive dhe të ndihmojnë në krijimin e një mjedisi bashkëpunues të të nxënësve. Një mjedis mikpritës, gjithëpërfshirës dhe ftues për të gjithë është thelbësor për besimin, vetëbesimin dhe ndjenjën e përkatësisë së nevojshme për të nxënë pa frikën e dështimit.

Mjetet dhe strategjitë për të filluar të nxënësve në shkollë duke u përqendruar te mjetet mësimore (si?)

Pyetjet kryesore:

- Si mund të zhvilloj më tej komunikimin me prindërit dhe nxënësit?
- Si mund të përfitojë të nxënësve në klasë nga strategjitë e të nxënësve të vetë-drejtuar të

zhvilluara nga fëmijët?

- Si mund të përdor mjete digjitale gjatë të nxënësve në klasë?

Mjetet elektronike dhe pajisjet digjitale do të kenë luajtur një rol thelbësor në jetën e shumë mësuesve, prindërve dhe nxënësve gjatë punës ose të nxënësve në shtëpi. Në mungesë të mjeteve të përshtatshme, disa familjeve mund t'u jetë dashur të improvizojnë dhe gjejnë zgjidhje alternative. Mënyra se "si" të nxënësve dhe të punojnë mund të ketë qenë një shqetësim i madh, por nëse shohin pas shumë do të kuptojnë që kanë pasur një kurbë të nxënësve në rritje. Për më tepër, mund të kenë hulumtuar dhe vendosur mënyra të reja për të komunikuar. Do të ishte për të ardhur keq nëse mënyrat e shfrytëzueshme të të nxënësve dhe komunikimit nuk do të transferoheshin në klasë. Por mësuesit, prindërit dhe nxënësit e tjerë mund të kenë hasur vështirësi gjatë këtyre javëve për të aksesuar materialet mësimore, për shkak të mungesës së mjeteve mësimore digjitale ose sepse familjet dhe mësuesit nuk patën mundësi të qëndronin në kontakt. Problemet e komunikimit që ekzistojnë përpara izolimit mund të shfaqen si probleme të rëndësishme që duhen zgjidhur. Pyetjet e mëposhtme mund të ndihmojnë mësuesit të adresojnë çështjet kyçe:

Si mund t'i ndihmoj fëmijët në kalimin nga mjedisi në shtëpi në atë në shkollë?

Duke pasur parasysh situatën aktuale, shkollat duhet të hartojnë një plan kalimi, veçanërisht nëse shkollat nuk rifillojnë menjëherë me programet dhe veprimtaritë e tyre me kohë të plotë. Këto plane duhet të ndahen me prindërit për të parashikuar probleme të mundshme. Edhe nëse prindërit dhe mësuesit kishin pak kontakte para izolimit, tani është e nevojshme të dini si janë nxënësit tuaj dhe për çfarë kanë nevojë ata. Kanalet ekzistuese të komunikimit duhet të përdoren dhe nëse është e mundur të krijohen kanale të reja për të qëndruar në kontakt të ngushtë gjatë fazës së kalimit. Megjithatë jo të gjitha problemet ekzistuese mund të zgjidhen menjëherë, është e rëndësishme të shkëmbehen informacione në mënyrë aktive dhe të shkëmbehen pritshmëritë për të nxënësve e fëmijës në të ardhmen. Të gjithë ata të përfshirë duhet ta kufizojnë veten nga kërkimi i zgjidhjeve të shpejta në kurriz të njëjës apo tjetrës palë. Dhe mbi të gjitha, nxënësit nuk duhet të fajësohen ose të vihen në pozitë të pafavorshme vetëm sepse nuk patën mundësitë e duhura për të mësuar.

Si mund të mbështes strategjitë vetë-rregulluese të nxënësve?

Aftësia vetë-rregulluese e nxënësve për të mos hequr dorë kur hasin vështirësi dhe për të reflektuar mbi strategjitë e të nxënësve është një kompetencë kyçe për çdo nxënës të suksesshëm. Aftësia për t'u përshtatur me ndryshimin, për të përballuar frustrimin ose për të qëndruar i qetë kur hasen me probleme ndihmon në menaxhimin e vështirësive. Disa nxënës mund të kenë pasur mundësinë të zhvillojnë këto aftësi gjatë fazës së të nxënësve në shtëpi, ndërsa të tjerë jo. Disa mësues presin që nxënësit të kenë përvetësuar këto aftësi dhe nuk kanë dëshirë të investojnë kohë për t'i ndihmuar nxënësit të përvetësojnë strategjitë dhe mjetet e nevojshme mendore.

Mbështetja e fëmijëve për të përmirësuar ndjenjën e tyre të vetë-efikasitetit është një nga ndërhyrjet më të fuqishme për të përmirësuar të nxënit. Nëse emocionet bëhen pengesë për të nxënit, fëmijët mund të kenë nevojë për mbështetje psiko-sociale, por mësuesit mund t'i ndihmojnë nxënësit të rregullojnë emocionet dhe frikërat. Ndryshimet e thjeshta si përfshirja e veprimtarive të lëvizjes dhe lejimi që fëmijët të bëjnë pushime të shkurtra kur kanë nevojë, mund të kenë efekte pozitive në aftësitë vetë-rregulluese.

Si mund të vazhdoj të përdor strategji efektive të të nxënit të zhvilluara në shtëpi?

Duke qenë të detyruar të punojnë në mënyrë të pavarur, disa nxënës mund të kenë zhvilluar strategji të pazakonta, por efektive për të kapërcyer pengesat, për të menaxhuar mungesën e motivimit, ndërprerjen e mësimit, përdorimin e pajisjeve elektronike në mënyra që mësuesve thjesht nuk do t'u kishin shkuar kurrë ndër mend. Kjo është një mundësi e mrekullueshme për të nxënë nga nxënësit dhe për të provuar të njëjtat metoda me nxënës të tjerë. Reflektimi mbi strategjitë e të nxënit të aplikuara gjatë izolimit dhe vlerësimi i efektshmërisë së tyre është një element i rëndësishëm i të qenit një nxënës më efektiv.

Si mund të përdor mjete digjitale në klasë?

Pjesa më e madhe e fëmijëve kanë përdorur disa pajisje elektronike të mjeteve digjitale gjatë izolimit. Nëse fëmijët i përdorin këto mjete në mënyrë të suksesshme, mësuesit duhet të marrin në konsideratë të lejojnë nxënësit të përdorin këto pajisje. Madje disa shkolla mund të ndjekin politikën “sill pajisjen tënde”, veçanërisht nëse shkollat nuk mund të përballojnë të sigurojnë këto mjete për të gjithë nxënësit. Në çdo rast, mësuesit duhet të marrin në konsideratë përdorimin e vazhdueshëm të mjeteve digjitale në klasat e tyre dhe të zgjerojnë këto mundësi mësimore për të gjithë nxënësit. Mësuesit mund të zhvillojnë një koncept të mësimit të përzier bazuar në përvojat e zhvilluara dhe të ndara nga nxënësit dhe prindërit.

Integrimi i teknologjisë në klasë gjithashtu do t'u japë nxënësve të pafavorizuar një mundësi për t'u njohur me mësimin online dhe për të përfituar nga njohuritë dhe përvojat e marra gjatë izolimit. Nëse shkolla nuk është në gjendje të blejë pajisjet e nevojshme, mësuesit mund të marrin parasysh veprimtaritë e mbledhjes së fondeve. Para se ta bëni këtë, duhet të përcaktohet nëse një iniciativë e tillë është e mirëpritur nga autoritetet e arsimit dhe prindërit.

Si mund të kontrolloj ecurinë individuale të nxënësve?

Vlerësimi i të nxënit është vetëm hapi i parë për të mbështetur nxënësit individualisht dhe për t'i ndihmuar ata gjatë rrugës së tyre të të nxënit. Shumëllojshmëria e të nxënit kërkon mënyra novatore të mësimdhënies dhe të nxënit, të ngjashme me mënyrat me të cilat nxënësit e suksesshëm mësuan në shtëpi. Mësuesit dhe nxënësit mund të kenë krijuar madje edhe rutina të reja për të siguruar reagime dhe për të

mbështetur veprimtaritë e ardhshme mësimore. Disa mësues mund të kenë zhvilluar sisteme funksionale për të mbajtur nën kontroll të gjithë nxënësit, të cilat ata mund t'i ndajnë me kolegët për t'i zbatuar si një sistem të përhershëm. Të tilla mjete janë të rëndësishme pasi iu japin mundësi mësuesve të rishikojnë të nxënit e vetë-drejtuar të nxënësve. Mund të zhvillohet një procedurë pas përvojave gjatë mësimin në shtëpi për të përcaktuar objektiva mësimore kuptimplota e të gjera, mund të vendosni objektiva si mbledhja e informacionit fillimisht, pastaj zhvillimi i një projektplanit që e bën mësimin të dukshëm dhe të përcaktoni rezultatet konkrete ose produktet sipas të cilave mund të matet suksesi.

PJESA 3: KRIJIMI I MËNYRAVE TË PERSONALIZUARA TË TË NXËNIT PËR NXËNËSIT

Krijimi i mënyrave të personalizuar të të nxënit për nxënësit: Analiza e situatës

Kriza COVID-19 ka prekur jetën e të gjithë atyre që banojnë në vende të goditura nga pandemia. Askush nuk e di saktësisht se cilat do të jenë efektet afatgjata në lidhje me kostot ekonomike, sociale dhe arsimore. Ekziston frika për një valë e dytë dhe ka gjasa që edhe për disa kohë do vazhdojë të ketë kufizime të lirisë së lëvizjes dhe lirisë së tubimit. Masat e distancimit fizik dhe të higjienës duhet të respektohen ende dhe vendet publike duhet të provojnë se janë në gjendje të mbrojnë njerëzit. Shtetet duhet të balancojnë nevojën për të mbrojtur jetën e njeriut me parandalimin e problemeve ekonomike, sociale, arsimore dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Në kohë krizash dhe pasigurish, sistemet sociale dhe arsimore duhet të sigurojnë vijueshmërinë e shërbimeve, por në të njëjtën kohë punojnë nën stres dhe kanë mungesë stafi. Grupet e cënueshme dhe popullatat e marginalizuara kanë nevojë për mbrojtje të veçantë pasi ato mund të preken më shumë nga sëmundja ose nga efektet e saj dytësore. Këto shqetësime zgjerohen në komunitetet ku jetojnë fëmijët, të cilat kanë nevojë për koordinim dhe komunikim midis shkollave dhe përfaqësuesve të komunitetit.

Përjetimi i stresit dhe i pasigurisë është prezent në çdo shkollë ku ka rifilluar mësimi, sepse nxënësit duhet t'u përmbahen rregullave të reja, të qëndrojnë të ndarë fizikisht nga fëmijët e tjerë dhe të ruajnë distancimin fizik edhe me mësuesit. Kjo është një përvojë e re për shumë nxënës, por për disa përjetimi i distancimit fizik dhe social në shkollë është një shqetësim i përhershëm. Mund të përmendim këtu fëmijët me aftësi të kufizuara ose me prejardhje nga familje që jetojnë në kushte të pafavorshme, të cilët mund të duken si një kërcënim i mundshëm për mirëqenien e nxënësve të tjerë. Prindërit dhe mësuesit kanë frikë se ata kanë ndikim negativ në nivelet e përgjithshme të arritjeve të klasës dhe një ndikim të keq në sjelljet dhe qëndrimet e nxënësve të tjerë. Pozicioni i tyre shoqëror në shtëpi dhe në shkollë është shpesh i pasigurt dhe nëse shfaqen probleme, ata janë të parët që mendohet të jenë shkaku. Në rastin më të mirë, këta fëmijë janë në rrezik më të lartë për t'u ekspozuar ndaj problemeve të shëndetit mendor, dhunës në familje, privimit ekonomik dhe social. Në kohë krize, ata janë të parët që përjetojnë marginalizim apo edhe përjashtim. Për shembull, *vendbanimet romë në të gjithë Evropën u goditën rëndë nga koronavirusi për shkak të hapësirave të ngushta të jetesës, aksesit së kufizuar në informacion dhe në shërbimet shëndetësore. Shumë u vendosën në karantinë gjatë krizës së COVID-19, disa të tjerë u përdorën si 'kokë turku'.* Kjo mund të ndodhë sërish nëse nivelet e infeksionit rriten sërish.

Kriza COVID-19 ka funksionuar si një xham zmadhues për të parët të metat e shoqërisë: ndarjet digjitale dhe socio-ekonomike, mungesa e shërbimeve themelore për popullatat e cënueshme dhe situata e pasigurt e jetës së emigrantëve ose e refugjatëve pa dokumente. Por ajo, gjithashtu, ka vënë në qendër të vëmendjes sjelljen prosociale, ku

fqinjët spontanisht organizuan mbështetje për të ndihmuar të cënueshmit. Shumë shkolla dhe mësues punuan për t'u siguruar që nxënësit e tyre përtej detyrave kishin ushqim dhe mundësi për të mësuar. Ata përjetuan fuqinë shëruese të marrëdhënieve ndaj ndjesisë të të qenit të pafuqishëm që shtohet në mungesë të marrëdhënieve të tilla. Mësuesit menduan për mënyra të reja për të arritur nxënësit e tyre dhe provuan qasje që më parë nuk do t'i kishin konsideruar kurrë. Shumë shkolla morën një hap për të sjellë risi në mësimdhënien dhe të nxënësit në një mënyrë që ata nuk mendonin më parë se mund të ishte e mundur. T'i bënin fëmijët të mësonin u bë më e rëndësishme sesa këmbëngulja që një detyrë e caktuar të plotësohej në një kohë të caktuar. Vlerësimi formues mori përparësi ndaj provimeve dhe mësuesit nisën të kërkojnë mundësi të disponueshme të të nxënësit në kushtet e shtëpisë. Me fjalë të tjera, mësuesit *u detyruan* të njohin larminë e situatave jetësore të nxënësve dhe u përpoqën të bënin më të mirën në ato situata. Ata mbollën farat e arsimit gjithëpërfshirës.

Arsimi tradicional nuk është i orientuar drejt menaxhimit të diversitetit, por në fakt e kundërta është e vërtetë. Sistemet arsimore janë krijuar për t'u siguruar shkollimin grupeve homogjene. Premisa themelore është se mësimdhënia e të njëjtës përmbajtje në të njëjtën kohë funksionon vetëm nëse fëmijët janë të së njëjtës moshë, në të njëjtin nivel zhvillimi dhe njohurie dhe janë në gjendje të mësojnë me të njëjtën shpejtësi. Kjo mund të jetë një mënyrë efikase e të nxënësit të aftësive themelore të leximit dhe të shkrimit nga mësuesit me trajnim shumë të kufizuar në klasa me pesëdhjetë ose më shumë fëmijë, por sigurisht që nuk është mënyra më e mirë e të nxënësit. Metodatat e standardizuara të mësimdhënies çuan në përjashtimin e fëmijëve që nuk mundën të përshtaten me këtë regjim dhe ngritjen e programeve të specializuara dhe të shkollave speciale.

Për shkak të krizës COVID-19, ndryshimi i niveleve të arritjeve ka të ngjarë të rritet. Sistemet arsimore mund të tundohen nga ideja për të krijuar më shumë shërbime speciale për t'u kujdesur për nevojat mësimore të fëmijëve të identifikuar si "të veçantë", si fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët me probleme të shëndetit mendor, fëmijët me rezultate të ulëta akademike, fëmijët romë, fëmijët emigrantë apo refugjatë ose mund të shfrytëzojnë mundësinë dhe të përmirësojnë aftësitë e mësuesve për të dhënë mësim për grupe të ndryshme fëmijësh. Në të gjithë botën sistemet arsimore gjithëpërfshirëse, të drejta dhe me cilësi të lartë kanë pasur performancë më të mirë se sistemet e arsimit special. Por sistemet arsimore gjithëpërfshirëse janë të suksesshme vetëm nëse përdorin një qasje të përqendruar te nxënësit:

- Në qendër të mësimdhënies është të nxënësit e nxënësve dhe përvoja e tyre e përgjithshme e të nxënësit jo mësuesi;
- Përvetësimi i kompetencave për zgjidhjen e problemeve konsiderohet si më e rëndësishme se njohja e përmbajtjes kurrikulare;
- Bashkëpunimi nxitet dhe stimulohet për t'u dhënë nxënësve mundësinë të nxënë prej njëri-tjetrit.

Gjatë krizës COVID-19, shumë shtete, ministri, shkolla dhe mësues kanë marrë

vendime kundër ndarjes, për shembull duke shmangur vënien e notave dhe duke i lejuar të gjithë nxënësit të kalojnë klasën. Në mungesë të një klase, mësuesit u detyruan të mendojnë nga këndvështrimi i nxënësve të tyre. Ata filluan të hartojnë plane individuale të të nxënësve për të gjithë nxënësit dhe të zhvillojnë një kuptim të ri për t'i mbështetur sa më shumë nxënësit në të nxënësve të tyre. Ata morën njohuri për familjet dhe situatat si kurrë më parë dhe dëshmuar se si prania ose mungesa e mbështetjes ndikoi në motivimin dhe të nxënësve. Mësuesit edhe janë habitur duke parë disa fëmijë të përparojnë më shumë dhe të përfitojnë nga mësimi në distancë. Shkurt, mësuesit filluan të përjetojnë të nxënësve së bashku me nxënësit e tyre. Dhe pikërisht këtu fillon krijimi i mënyrave të personalizuar të të nxënësve, nga situata e të nxënësve të nxënësve.

Krijimi i mënyrave të personalizuar të të nxënësve për nxënësit: Çështjet dhe pyetjet kyçe

Të kuptojmë situatën e të nxënësve të nxënësve duke u përqendruar te nxënësi (Kush?)

Çështjet kryesore:

- Çfarë mund të bëj për t'u siguruar që nxënësit të bëhen nxënës fleksibël;
- Si mund të nxis një qëndrim pozitiv ndaj të nxënësve;
- Si mund t'i fuqizoj nxënësit të bëhen të pavarur.

Gjatë krijimit të mënyrave të personalizuar të të nxënësve, nxënësi është në qendër. Çdo nxënës është unik, me një potencial unik për të nxënë, talente unike dhe me një kontribut unik për të dhënë për të nxënësve të tjerëve. Personalizimi i të nxënësve nuk do të thotë që nxënësit të punojnë vetë ose në izolim, por do të thotë që çdo nxënës perceptohet si një kontribues unik i një komuniteti nxënësish. Të nxënësve është i mundur vetëm nëse fëmijët dhe të rinjtë besojnë se janë në gjendje të mësojnë dhe se kontributi i tyre vlerësohet. Identiteti pozitiv, aftësia për të kapërcyer vështirësitë e për t'u rimëkëmbur dhe ndjesia e të qenit në kontroll u japin nxënësve forcën e nevojshme për të trajtuar sfidat e paeksploruara të të nxënësve.

Pyetjet e mëposhtme e ndihmojnë mësuesin të nxisë këto karakteristika te nxënësit.

Si mund ta mbështes fleksibilitetin e nxënësve?

Fleksibiliteti është aftësia për të menaxhuar përvojat stresuese, për t'u përballuar me fatkeqësi dhe për të përparuar përballë ndryshimit. Është aftësia për t'u rikuperuar nga ngjarjet traumatike dhe rritja gjatë procesit. Fleksibiliteti nuk është e aftësi e lindur. Ai ndërtohet përmes marrëdhënieve të besueshme që ofrojnë mbështetje dhe përcjellin besim në aftësitë e fëmijës për të kapërcyer situatat e vështira. Fëmijët fleksibël do ta marrin veten nga ndërprerja e shkaktuar nga COVID-19 dhe do të vazhdojnë të nxënë. Ndjesia e të qenit i lidhur ose i të qenit pjesë është një faktor mbrojtës i rëndësishëm dhe kontribuon në zhvillimin e fleksibilitetit. Mësimi social dhe emocional i ndihmon

nxënësit të zhvillojnë vetëdijen, vetëmenaxhimin, si dhe vetëdijen sociale. Të gjitha së bashku janë thelbësore për të zhvilluar fleksibilitetin e tyre.

Si mund të forcoj identitetin e nxënësit?

Për shkak të krizës COVID-19, mësuesit kanë qenë të ekspozuar si kurrë më parë ndaj mjedisit shtëpiak të nxënësve dhe situatës familjare. Ata mund të kenë marrë njohuri të reja mbi mënyrën se si fëmijët jetojnë, pritshmëritë e prindërve dhe mbështetjen që nxënësit kanë marrë ose jo gjatë izolimit. Gjithashtu, ata mund të kenë parë konflikte në të cilat fëmijët janë ekspozuar kur janë përpjekur të ngrenë ura midis kulturave të ndryshme në shtëpi dhe në shkollë. Zhvillimi i identitetit pozitiv është thelbësor për t'u bërë një nxënës me vetëbesim. Veçanërisht, fëmijët me prejardhje nga minoritetet ose fëmijët me aftësi të kufizuara po përballen me vështirësi për t'u përshtatur me normat e ngurta dhe pritshmëritë e grupit. Mësuesit që tregojnë empati ndaj konfliktet e nxënësve në lidhje me identitetin e tyre mund të bëjnë ndryshime duke njohur përpjekjet e mëdha që kërkohen nga nxënësit për të balancuar prejardhjen e tyre me atë çfarë pritet prej tyre në shkollë. Mësuesit duhet të mbështesin nxënësit të shprehen, në vend që të shtypin mendimet, impulset dhe idetë e tyre. Kushdo qofshin, ndjesia aktuale e nxënësve për vetveten shënon fillimin e udhëtimit për të zgjeruar horizontet e tyre dhe përvetësimin e njohurive të reja.

Si mund t'i ndihmoj nxënësit të zhvillojnë një mendësi rritjeje?

Nxënësit nuk mund të bëhen nxënës aktivë me vetëbesim nëse nuk besojnë se përmes të nxënës ata mund të transformohen për mirë. Për sa kohë që nxënësit besojnë se prejardhja e tyre familjare, aftësitë e tyre të kufizuara ose mungesa e inteligjencës është fati i tyre, këto besime do të pengojnë të nxënin e tyre. Jo vetëm nxënësit, por as mësuesit nuk duhet të kenë pikëpamje të tilla për nxënësit e tyre. Mendësitë e pandryshueshme shenjëstrojnë profecitë e vetëpërmbyshjes. Besimi se fëmijët me inteligjencë të ulët nuk janë në gjendje të nxënë, sjell pritshmëri të ulët të mësuesve për këta fëmijë, e cila shprehet në përcaktimin e rezultateve të ulëta, të dhënies së detyrave më pak sfiduese dhe përpjekje më të pakta nga mësuesit për të udhëhequr nxënësit në këto vështirësi. Zhvillimi i një mendësie rritjeje lidhet me besimin se përpjekja që bën nxënësi është më e rëndësishme se rezultati që arrin dhe se gabimet janë një mundësi për të nxënë dhe jo një arsye për t'u ndier i turpëruar. Mendësitë mund të eksplorojnë së bashku me fëmijët duke folur për natyrën e inteligjencave, njohuritë dhe të nxënit.

Si mund të mbështes optimizmin e nxënësit për të nxënit?

Siç u përmend më herët, pritshmëritë janë parashikues të fuqishëm të së ardhmes, sepse ndikojnë në ndërveprimet tona me të tjerët. Atribuimi rastësor i arsyeve pse nxënësit nxënë apo jo në shkollë ka ndikim të drejtpërdrejtë në të nxënit e tyre. Optimizmi ose pesimizmi për arritjet e ardhshme të nxënësve janë faktorë të rëndësishëm. Shpjegimet pesimiste i shohin shkaqet e problemeve aktuale si të përhershme, mbizotëruese dhe personale, ndërsa shpjegimet optimiste përqendrohen

në shkaqe të përkohshme, specifike dhe të ndryshueshme. Mësuesit dhe prindërit mund të kenë të njëjtin mendim pesimist, duke e bërë praktikisht të pamundur që fëmija të jetë optimist në lidhje me të nxënit e tij. Nxënësit mund të mësojnë të jenë optimistë nëse mësuesit u mësojnë atyre të riformulojnë shpjegimet pesimiste.

Si mund të fuqizoj nxënësit të bëhen nxënës aktivë?

Mënyrat e personalizuar do të funksionojnë vetëm për nxënësit që janë në gjendje të përfshihen në mënyrë aktive dhe të rregullojnë të nxënit e tyre. Nxënësit duhet të nxiten të bëjnë pyetje, të krahasojnë njohuritë e marra më parë me njohuritë e reja dhe të shkëmbejnë ide me të tjerët për të thelluar të kuptuarit e tyre. Nxënësit aktivë përfshihen emocionalisht, në mënyrë njohëse, sociale dhe marrin përgjegjësi për të nxënit e tyre duke reflektuar në mënyrë kritike atë që kanë nxënë ose duke reflektuar ku kanë nevojë për mbështetje ose udhëzime. Për të qenë nxënës aktivë, fëmijët duhet të bëjnë më shumë se sa thjesht të dëgjojnë. Ndërkohë që ishin jashtë shkollës gjatë izolimit, disa nxënës mund të jenë kthyer në nxënës aktivë. Nxënës të tjerë duhen ndihmuar në mënyrë që të përftojnë nga përvojat e tyre në kushtet e shtëpisë.

Vendosja e qëllimeve me vizionin e zgjerimit të aftësive duke u përqendruar në qëllimin e të nxënit (Pse?)

Çështjet kryesore:

- Si mund të sigurohem që të nxënit kontribuon në hapjen e së ardhmes për nxënësit;
- Çfarë duhet të mësojnë nxënësit për t'u bërë vetvetja dhe për të zhvilluar një identitet pozitiv;
- Si mund të fuqizoj nxënësit të bëhen nxënës më të pavarur.

Qëllimi i arsimit është të ndihmojë nxënësit të vazhdojnë me sukses në rrugën e të nxënit gjatë gjithë jetës, të bëhen qytetarë të përgjegjshëm dhe kontribues. E fundit, por jo nga rëndësia, të bëhen vetvetja. Kriza COVID-19 ka nxjerrë në pah rëndësinë e të pasurit të burimeve, të fleksibilitetit, të kompetencave sociale dhe emocionale, si dhe të aftësisë për të zgjidhur probleme. Kriza na ka kujtuar rëndësinë e respektimit të hapësirës private të njerëzve të tjerë, ndërkohë që qëndrojmë së bashku si komunitet. Gjithashtu, kriza ka ngritur pyetje me mënyrën se si duhet të përgatisim fëmijët për një të ardhme të pasigurt.

Çfarë duhet të nxënë fëmijët tani për të pasur mundësinë të bëjnë gjënë më të mirë për jetën e tyre? Padyshim që ata duhet të ndihen mirë me veten, të kenë marrëdhënie të mira me të tjerët, të ndihen se u përkasin një komuniteti mbështetës dhe që janë të aftë të kontribuojnë në atë që u intereson atyre dhe jo të tjerëve. Mësuesit duhet ta mbështesin këtë proces duke i ndihmuar nxënësit të zhvillojnë jo vetëm aftësi dhe kompetenca, por edhe ndjesinë e të qenit në kontroll.

Pyetjet e mëposhtme mund të ndihmojnë mësuesit të eksplorojnë çështjet kyçe.

Si mund t'i mbështes nxënësit të bëhen vetvetja?

Çdo person mund të bëhet versioni më i mirë i vetvetes, por nuk mund të bëhet një person tjetër. Kriza e COVID-19 ka vënë në dyshim shumëçka që ne i kemi marrë për të mirëqena. Pasiguritë përpara nesh tani janë mjaft thelbësore, siç është e ardhmja e nxënësve. Pra, *si mund t'i mbështesim fëmijët të bëhen vetvetja dhe të bëhen kontribues efektivë në shoqëri nëse nuk ka asnjë mënyrë që të dimë se çfarë do na sjellë e ardhmja?* Mund të themi me siguri që nxënësit do të kalojnë më mirë nëse ata janë të fuqizuar, me vetëbesim dhe të aftë të bëjnë zgjedhjet e duhura. Mësuesit mund t'i mbështesin këto cilësi duke u ofruar nxënësve mundësi për të provuar pozicione të ndryshme sociale, të zhvillojnë vetëdijen, të mësojnë t'i shohin gjërat nga këndvështrime të ndryshme dhe të eksplorojnë botën përreth tyre.

Si mund t'i mbështes nxënësit të bëhen bashkëpunues të fortë?

Të qenit i aftë për të krijuar marrëdhënie me të tjerët dhe bashkëpunuar gjatë eksplorimit të territoreve të paeksploruara, janë padyshim aftësitë kyçe për të trajtuar sfidat në të ardhmen. Bashkëpunimi midis nxënësve për të mbështetur të nxënit duket antintuitiv për shumë mësues. Ata besojnë se puna në grup i lë mbrapa nxënësit e mirë dhe nuk i siguron nxënësve të dobët udhëzimet e nevojshme. Madje, ata dyshojnë se disa nxënës kopjojnë dhe përfitojnë nga puna e të tjerëve. Përkundrajt këtyre besimeve, nxënësit nxënë më mirë në mjedise mësimore ku nxitet bashkëpunimi dhe të gjithë nxënësit janë në gjendje të kontribuojnë drejt zgjidhjes së problemit. Nuk ka një metodë apo strategji specifike për t'u zbatuar. Çështja ka të bëjë me mundësinë që të gjithë nxënësit të përfshihen në mënyrë aktive dhe të kenë një zë në atë që ndodh në klasë.

Si mund t'i ndihmoj nxënësit të zhvillojnë talentet e tyre?

Një qasje e bazuar në forcë kërkon të zhvillojë dhe të mbështesë pikat e forta dhe aftësitë ekzistuese në kundërshtim me përqendrimin te problemet, shqetësimet ose mangësitë. Kjo qasje ndan problemet nga personi dhe kërkon t'i forcojë nxënësit për t'u dhënë mundësi të kapërcejnë problemet ekzistuese. Talentet janë ndjeshmëri ose aftësi të veçanta për të zhvilluar ekspertizën në fushat ku fëmijët përjetojnë një ndjesi kënaqësie, përfshirje totale në një detyrë që e bën kohën të duket se po fluturon. Tradicionalisht, shkollat ofrojnë programe të veçanta vetëm për të zgjeruar talentin kur ato përkojnë me përmbajtjen dhe qëllimet kryesore të kurrikulës. Vetëm nxënësit e mirë konsiderohen të jenë të talentuar. Nxënësve të tjerë u mohohet mundësia e eksplorimit. Mësuesit duhet të kërkojnë në mënyrë të vazhdueshme momente kur nxënësit përjetojnë një ndjenjë të "rrjedhës (rrymës)", duke i frymëzuar që të zhvillojnë një vizion se ku mund t'i çojë kjo ndjenjë dhe çfarë mund të arrijnë në të ardhmen. Anëtarët e familjes ose miqtë e ngushtë shpesh janë ata që e shohin potencialin e një nxënësi shumë kohë përpara se ta bëjnë mësuesit. Duke pasur një vizion se kush dëshiron të bëhesh, vështirësia e të nxënit ulet.

Si të sigurohem që të gjithë fëmijët po nxënë në mënyrë efektive?

Fëmijët mësojnë nëpërmjet veprimit, duke u përfshirë në përvoja dhe duke bashkëvepruar me njerëzit. *Por si mundën mësuesit t'i mbështesin nxënësit që t'i bëjnë të gjitha këto në mënyrë më efektive?* Duke e vendosur të nxëniet dhe jo arritjet në qendër të mësimdhënies, mësuesit zhvendosin vëmendjen e nxënësve drejt aftësisë së tyre për të nxënë.

Mësuesit flasin me nxënësit në mënyrë të qartë për strategjitë e të nxëniet dhe të kuptuarit se ç'do të thotë të jesh nxënës efektiv. Të nxëniet nuk është një produkt anësor i performancës së mirë, përkundrazi, performanca mund të jetë një tregues i të nxëniet, por ajo nuk dëshmon domosdoshmërisht që ky nxënës mund të mësojë lehtësisht. Nxënësit efektivë janë të motivuar në thelb të eksplorojnë, të monitorojnë në mënyrë kritike sjelljen e tyre të të nxëniet dhe janë në gjendje të menaxhojnë zhgënjimin, mungesën e motivimit dhe të kërkojnë ndihmë kur është e nevojshme. Mësuesit mund të mbështesin nxënësit për të zhvilluar marrjen e kontrollit, marrjen e përgjegjësisë për të nxëniet e tyre dhe marrjen e nismës në vend që të ndjehen të pafuqishëm.

Si mund t'i ndihmoj fëmijët të zhvillojnë qëllime personale të të nxëniet?

Një nga qëllimet më të rëndësishme të arsimit është që nxënësit të jenë të aftë të nxënë vetë dhe të përgatiten për të nxënë gjatë gjithë jetës. Duke i ndihmuar nxënësit të zhvillojnë interesin për të nxënë, të marrin përgjegjësi, të marrin përsipër të nxëniet e tyre, si dhe të vendosin qëllime të larta, por realiste, mësuesit mundësojnë që fëmijët të mbeten nxënës aktivë edhe pas përfundimit të shkollës. Pa pritshmëritë pozitive për atë që mund të arrijnë, nxënësit nuk janë në gjendje të vetërregullojnë të nxëniet e tyre. Pritshmëritë e ulëta bëhen profeci vetëpërmbushëse dhe krijojnë rrathë viciozë nga të cilët është e vështirë të shpëtohet. Kur nxënësit përfshihen në mënyrë aktive në përcaktimin e qëllimeve, ata bëhen partnerë në të nxënë, duke njohur dhe kuptuar se çfarë pritet prej tyre.

Mësuesit duhet të ndihmojnë nxënësit e tyre në përcaktimin e hapave realistë për qëllimet e tyre të mëdha. Për shembull, nëse një person bëhet aktor apo jo varet nga aftësia e tij për të lexuar dhe mbajtur mend tekste të ndryshme. Dhe për të qenë në gjendje ta bëjmë këtë në të ardhmen, është e rëndësishme që ata të mësohen dhe të gjejnë mënyrat si t'i mbajnë mend më mirë njohuritë. Shndërrimi i qëllimeve afatgjata në qëllime afatmesme dhe të kuptuarit se detyrat aktuale kontribuojnë drejt tyre, u jep kuptim punëve të përditshme dhe i ndihmon nxënësit të mendojnë për qëllimet e tyre të të nxëniet.

Zhvillimi i një kurrikule të bazuar te nxënësit duke u përqendruar te të nxëniet (Çfarë?)

Çështjet kryesore:

- Nëse kurrikula kërkon zhvillimin e kompetencave, çfarë do të thotë kjo për mësuesit dhe nxënësit;
- Si mund t'i mbështes nxënësit që të ndjekin mënyrat e tyre të të nxëniet brenda kontekstit të kurrikulës;

- Si mund të ndihmojë përmbajtja e mësimit digjital në krijimin e një kurrikule me në qendër nxënësin.

Kurrikula ka për qëllim të lehtësojnë të nxënit për nxënësin. Për këtë arsye, kurrikulat e sotme në mbarë botën janë të bazuara në kompetenca. Ato e vendosin të nxënit e nxënësve në qendër të vëmendjes së mësuesve. Një kurrikul e bazuar në kompetenca duhet të jetë mjaftueshëm fleksibël për t'i lejuar nxënësit të nxënë me ritmin e tyre, por me tregues të qartë të asaj që duhet të kishin mësuar deri në fund të shkollimit ose kur kalojnë në nivele më të larta të arsimit. Duke u përqendruar në kompetencat e jo në performancën e nxënësve, nxënësve u jepet mundësia që të shprehin aftësitë e tyre në mënyra të ndryshme. Koncepti i kompetencës përfshin komponentë ndërkurrikulare dhe pasqyron aftësinë për të zgjidhur probleme në vend të riprodhimit të njohurive. Në botën që po ndryshon me një ritëm gjithnjë e më të shpejtë, askush nuk e di saktësisht se çfarë njohurish do të nevojiten pas 20 vitesh. Prandaj, është më mirë që nxënësit të përgatiten për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe të jenë në gjendje të zgjidhin problemet e së ardhmes, pavarësisht natyrës së tyre. Nëse përmbajtja e të nxënit nuk është më problemi kyç, mënyrat e personalizuara të të nxënit janë një alternativë e mirë ndaj planeve të përcaktuara mësimore.

Pyetjet e mëposhtme mund të ndihmojnë mësuesit të eksplorojnë çështjet kryesore rreth zhvillimit të një kurrikule të bazuar te nxënësit.

Si mund të zbuloj nëse nxënësit e mi janë gati të mësojnë?

Veçanërisht fëmijët e *cënueshëm* mund të mos jenë të gatshëm të nxënë sipas kurrikulës pasi të kthehen në klasë. Ata mund të jenë të uritur, të stresuar ose të shqetësuar se nuk janë në gjendje të mbajnë të njëjtin ritëm me shokët e tyre të klasës. Mësuesit mund t'i ndihmojnë nxënësit me kalimin nga shtëpia në shkollë duke e filluar ditën me një ritual që bashkon të gjithë nxënësit si një komunitet. Gjithashtu, disa nxënës do të kenë nevojë për mbështetje për të marrë aftësi njohëse themelore siç janë përqendrimi dhe menaxhimi i stresit. T'i mësosh nxënësit të jenë të vetëdijshëm do të thotë të integrosh të nxënit social dhe emocional në praktika të përditshme të mësimdhënies duke i ndërgjegjësuar mbi çfarë duhet të jenë të gatshëm të nxënë. Të nxënit është më efektiv kur lidhet me atë çfarë nxënësit dinë, por që i çon ata përtej kufirit të njohurive dhe përvojave të tyre. Vigotski e quan këtë "zona e zhvillimit të përafërt".

Si mund ta bëj kurrikulën të aksesueshme për të gjithë nxënësit?

Nëse nxënësit nuk janë në gjendje të kuptojnë kurrikulën, ata nuk do të jenë në gjendje as të nxënë. Nëse interesat, karakteristikat, vlerat dhe trashëgimia kulturore e nxënësve nuk respektohet ata do të zhgënjehen dhe do të bëhen të largët me shkollën. Kurrikula mund të bëhet më e aksesueshme duke zgjedhur histori, shembuj ose tema që kanë domethënie për të gjithë nxënësit. Nëse nxënësit kanë vështirësi me leximin, përmbajtja e mësimit duhet të përfaqësohet në mënyra të tjera, për shembull duke i lejuar ata të dëgjojnë informacionin në vend që ta lexojnë atë. Digjitalizimi ofron shumë

mundësi për ta bërë kurrikulën më të aksesueshme, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara ose me probleme të të nxënës. Platformat e mësimi digjital ofrojnë formate alternative të të nxënës, për të aksesuar të njëjtën përmbajtje në formate të ndryshme. Përdorimi i mënyrave të ndryshme të përfaqësimit të të njëjtës përmbajtje do të thellojë kuptimin dhe do t'i ndihmojë nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike.

Si mund të vlerësoj sa e kanë kuptuar nxënësit lëndën?

Sipas taksonomisë së Bloom-it, të jesh në gjendje të marrësh ose të mbash mend informacionin është vetëm niveli i parë i njohjes. Testet e thjeshta shpesh nuk tejkalojnë këtë nivel dhe nuk u japin mësuesve informacione mbi thellësinë e të kuptuarit të zhvilluar nga një nxënës deri në atë moment. Nxënësit që e kanë përvetësuar kuptimin përkatës, janë në gjendje t'ua shpjegojnë atë nxënësve të tjerë me fjalët e tyre. Të jesh në gjendje t'u shpjegosh diçka të tjerëve është testi i vërtetë për të kuptuar nëse dikush e ka kuptuar një njohuri plotësisht. Vetëm atëherë njohuritë zbatohen me sukses për të zgjidhur probleme, për të reflektuar mbi rezultatin, për të pasuruar më tej njohuritë, për t'i përdorur dhe për të krijuar njohuri të reja ose për të transferuar njohuritë në situata plotësisht të ndryshme.

Duke përcaktuar detyra komplekse që kërkojnë nga nxënësit të bazohen në ekspertizën e tyre dhe të kuptojnë tema ose subjekte të ndryshme, mësuesit mund t'i vëzhgojnë nxënësit dhe të dokumentojnë mënyrën se si ata i adresojnë dhe i zgjidhin këto detyra.

Si mund të zhvilloj të nxënës me bazë problemin?

Të nxënës me bazë problemin është një qasje për të ndihmuar nxënësit të përfshihen në detyra komplekse që kërkojnë sintetizimin e njohurive dhe zbatimin e tyre. Të nxënës me bazë problemin ndihmon në zhvillimin e kompetencave dhe marrjen e situatës në kontroll duke vendosur një sfidë para nxënësve. Të nxënës me bazë problemin, ashtu si të nxënës me bazë projektet, vendos qëllime afatmesme që kërkojnë nga nxënësit të bëjnë një plan, të përcaktojnë qëllimet afatshkurtra dhe të ndjekin hapa të ndryshëm nga ato të sugjeruara nga mësuesi. Nxënësit përfshihen në klasë në biseda që u japin mundësi të diskutojnë, të argumentojnë dhe të shpjegojnë në vend që thjesht t'u përgjigjen pyetjeve. Nxënësit duhet të nxiten të dokumentojnë mendimet e tyre duke vizualizuar hapat e ndryshëm mësimorë. Duke zhvilluar detyra komplekse dhe stimuluese që marrin shkak nga interesat e nxënësve, mësuesit i nxisin ata të zhvillojnë një kuptim më të thellë të temës.

Si mund të përfshij mësimin digjital në kurrikul?

Kriza COVID-19 ka nxjerrë në pah rëndësinë e literaturës digjitale dhe ka motivuar shumë vende për të përshpejtuar përfshirjen e mësimi digjital në kurrikul. Një nga mënyrat si mund të realizohet mësimi digjital është prezantimi i detyrave në mënyrë digjitale në klasë, nëpërmjet platformave digjitale. Ekzistojnë shumë platforma dhe mund të jetë e vështirë për mësuesit dhe nxënësit të vendosin cilën të zgjedhin dhe si

të kombinojnë burimet elektronike me mësimin tradicional në klasë. Disa shtete kanë zhvilluar platforma mësimore që marrin të dhënat nga kurrikula zyrtare, por as kjo nuk garanton që detyrat e prezantuara në mënyrë digjitale janë superiore ndaj lehtësimit të të nxënësve nga mësuesit. Sistemet e menaxhimit të të nxënësve i lejojnë mësuesit dhe nxënësit të krijojnë mënyra të personalizuar të të nxënësve. Mësuesit dhe nxënësit duhet të përftojnë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për monitorimin e të nxënësve.

Krijimi i mjediseve të personalizuar mësimore duke u bazuar në kontekstin mësimor (Ku?)

Çështjet kryesore:

- Si mund të zhvillohen mjediset shkollare në mjedis të personalizuar të të nxënësve;
- Si mund të krijoj një mjedis mësimor që zhvillon të nxënësve të vetëdrejtuar;
- Si mund të ndërthur mjediset mësimore në klasë me ato digjitale.

Mjedi mësimor mund të lehtësojë ose të krijojë barriera për të nxënësve. Barrierat fizike prekin nxënësit me aftësi të kufizuara, për shembull nëse ka shkallë pa ashensor ose nëse tualetet janë shumë të ngushta për t'u aksesuar nga karriget me rrota. Por mjediset mësimore mund të krijojnë edhe barriera sociale, emocionale dhe njohëse për fëmijët me prejardhje të pafavorshme. Mjedi pozitiv i mësimit siguron hapësira të larmishme për të përmbushur nevojat e ndryshme të të gjithë nxënësve. Klima sociale e krijuar nga mësuesit duhet t'i nxisë nxënësit të përftojnë gjithçka që i duhet për të nxënë, për shembull mundësi për të pirë ujë ose për të bërë një pushim të shkurtër gjatë mësimi.

Mjedi mësimor që krijohet së bashku me nxënësit u jep atyre ndjenjën e të qenit pjesë dhe të përgjegjësisë, për shembull të kujdesen për bimën e tyre ose të kujdesen për një kafshë (nëse lejohet sipas rregullave të shkollës).

Shkollat miqësore me fëmijët i bëjnë të gjithë fëmijët të ndjehen të sigurt dhe të mirëpritur. Mjedi i mësimor krijon një klimë ku të gjithë respektohen dhe ku çdo fëmijë ka mundësinë të kontribuojë dhe të jetë pjesë e një komuniteti. Ky komunitet duhet të zgjerohet përtej klasës për të krijuar një atmosferë ku bullizmi i fëmijëve të cënueshëm dhe poshtërimi i fëmijëve thjesht, sepse janë ndryshe nuk tolerohet.

Pyetjet e mëposhtme adresojnë çështje të rëndësishme.

Si mund të përdor mjedisin shkollor për të krijuar mundësi të ndryshme të nxënësve?

Shumë shkolla ende sot duken më shumë si kazerma ushtarake sesa si vende që mirëpresin nxënësit të nxënë, të bëhen vetvetja dhe të ndihen si në shtëpi. Por edhe këto shkolla mund të kthehen në hapësira që ofrojnë mundësi të ndryshme mësimore për popullata të ndryshme nxënësish. Me pak përpjekje mund të bëhen shumë ndryshime, nëse mësuesit marrin parasysh perspektivën e nxënësve për mënyrën si ta bëjnë shkollën më miqësore. Oborret e papërdorura të shkollave mund të shndërrohen në mjedis ku fëmijët mund të përfshihen në veprimtari në grup, lojëra

ose kopshtari. Hapësirat boshe nën shkallë mund të kthehen në studio mësimore, korridoret mund të mbushen me bimë ose të përdoren për diskutime në grup. Klasa, nëse hapësira e lejon, mund të ndahet në seksione të ndryshme kur nxënësit mund të bashkohen për të dëgjuar mësuesin dhe për të diskutuar, ose në hapësira *private* ku ata mund të tërhiqen për të bërë një pushim të shkurtër. Nëse nxënësit do të përfshiheshin në mënyrë aktive në krijimin e këtyre hapësirave, ata do të mund të gjenin një mënyrë për t'i përdorur ato.

Si mund të krijohet një kulturë ku gabimet shihen si një mundësi?

Shumë nxënës i shohin gabimet si veprime të turpshme dhe si shenjë e të qenit jo normal. Mësuesit mund t'i përforcojnë këtë pikëpamje ose mund t'i ndihmojnë nxënësit të pranojnë gabimet si një mundësi për të përmirësuar kuptimin e tyre dhe për të thelluar më tej njohuritë. Klasat që nxjerrin në pah atmosferën e të nxënësve si sfida dhe i japin vlerë nxënësve sipas niveleve të arritjes së tyre kanë gjasa të krijojnë një klimë që nuk nxit pranimin e gabimeve. Por shmangia e gabimeve do t'i bëjë fëmijë të mbeten pas me mësimin e tyre, sepse gabimet janë thelbësore për të nxënë dhe për t'u përmirësuar. E njëjta gjë është e vërtetë edhe për mësuesit. Mësuesit bëhen shembull duke pranuar gabimet e tyre dhe duke mësuar prej tyre. Duke i ndarë gabimet me kolegët, ata mund të marrin një qasje proaktive drejt përmirësimit të mësimdhënies nëpërmjet të nxënësve nga kolegët. Një klimë në të cilën gabimet janë të mirëpritura nuk do të thotë që nxënësit që bëjnë gabime janë nxënës më të mirë se të tjerët që nuk bëjnë gabime. Qëllimi është krijimi i një mjedisi mësimor që pret që nxënësit të bëjnë gabime dhe i përdor këto gabime në mënyrë proaktive për të thelluar kuptimin. Në klasa të tilla mësuesit nxisin marrjen e rrezikut duke eksploruar përgjigje ose qasje të ndryshme. Ata nuk i lejojnë nxënësit të japin përgjigje të thjeshta për pyetje komplekse. Pyetjet e mira shihen si po aq të rëndësishme sa përgjigjet e sakta.

Si mund të krijohet një klimë ku vlerësimi mbështet të nxënësit?

Shumë mësues e kuptojnë vlerësimin formues si reagim ndaj procesit mësimor. Nëse ky reagim është i orientuar kryesisht drejt asaj që nxënësi ka nxënë tashmë, sesa në atë që nxënësi duhet të nxërë në vijimësi, në thelb nuk është ndryshe nga një test përmbledhës i bërë në fund të një kapitulli/periudhe. Për më tepër, qëllimet e larta të mësuesit për të përmirësuar të nxënësit nëpërmjet dhënies së reagimeve nuk do të kenë sukses nëse nga perspektiva e nxënësve perceptohet si gjykim i aftësive ose i mungesës së tyre.

Vlerësimi i të nxënësve nuk është diçka që bëhet nga mësuesit për nxënësit, ai duhet përfshirë në kulturën e të nxënësve. Klima e klasës duhet të zhvillohet në mënyra që mbështesin jo vetëm reagimet e mësuesve, por edhe reagimet e nxënësve dhe vetëvlerësimin. Vlerësimi për të nxënësit nxit bërjen e pyetjeve, veçanërisht rreth arsyes pse nxënësit duhet të përfshihen në një veprimtari specifike. Vëmendja e reagimit është në detyra, në atë si kryhet më mirë një detyrë ose çfarë duhet të presin nxënësit si rezultat i mirë.

Pritshmëritë shprehen dhe bëhen të dukshme për t'i udhëhequr nxënësit në të nxënësit

e tyre. Reagime për të përmirësuar mësimin nuk kërkohen vetëm nga mësuesit e tjerë të shkollës, por edhe nga nxënësit dhe prindërit.

Si mund të integroj mjediset e mësimin digjital në mësimin në klasë?

Shumë nxënës do të kenë përfutur përvojë duke lundruar në mjediset digjitale të të mësuarit dhe disa mund të kenë shijuar shumë mësimin online. Përvojat e tyre të të nxënës do të varfëroheshin nëse pasi të ktheheshin në klasë, këto mundësi të nxënës nuk do të ishin më të disponueshme. Mësimi i përzier është përdorur gjerësisht në arsimin e lartë në shumë shtete, por ende nuk është bërë i zakonshëm në klasat cikleve të ulta. Mësimi i përzier krijon mundësi për të personalizuar të nxënës pasi nxënësit të fitojnë aftësitë e nevojshme për të lundruar në internet ose në mjediset mësimore online pa humbur gjurmët e qëllimeve të tyre të të mësuarit.

Veçanërisht nxënësit me aftësi të kufizuara ose nxënësit me talente të veçanta të cilët, në të kundërt nuk kanë akses ndaj mundësive të të nxënës që adresojnë nevojat e tyre të veçanta, do të përfitojnë nga mjediset e përziera mësimore. Mbështetja e menjëhershme nga mësuesit mund të plotësohet me ekspertë në internet për të krijuar mjedise të personalizuar të të nxënës që përmirësojnë të nxënës në mënyrë të fuqishme.

Si mund t'i shfrytëzoj komunitetet e mësimin virtual si mjedise mësimore?

Në shekullin 21-të, të nxënës bashkëpunues nuk ndalet në muret e klasës, mund të krijohen komunitetet mësimore midis nxënësve dhe mësuesve në shkolla, komunitete apo edhe shteteve të ndryshme. Gjatë izolimit, shumë nxënës do të kenë provuar komunikimin në internet duke përdorur pajisje elektronike dhe programe të ndryshme komunikimi. Ata mund të kenë komunikuar me mësuesit dhe bashkëmoshatarët e tyre, por ndoshta edhe me të rritur ose fëmijë të tjerë që ishin të gatshëm dhe të interesuar për shkëmbimin e përvojave dhe mbështetjen e të nxënës. Këto kontakte mund të ushqehen dhe të zhvillohen në partneritete mësimore që shtrihen përtej klasës. Mund të vendosen kontakte me shkolla të tjera, në të njëjtin vend ose në vendet ku fëmijët flasin një nga gjuhët e huaja që nxënësit mësojnë në shkollë.

Përgatitja dhe mbajtja e një bisede në internet mund të jetë një nxitje e shkëlqyer për nxënësit, veçanërisht nëse fëmijët ndajnë të njëjtat interesa ose karakteristika të tjera. Ekzistojnë shumë mënyra për të bashkëvepruar me të tjerët në mënyrë digjitale dhe disa partneritete midis nxënësve madje mund të vendosen për një periudhë të tërë për të krijuar komunitetet e të mësuarit virtual që punojnë në të njëjtën temë ose projekt nga shkolla të ndryshme.

Mjete dhe strategji për të mbështetur të gjithë nxënësit duke u mbështetur te mjetet mësimore (Si?)

Çështjet kryesore:

- Si mund të krijoj mënyra të personalizuar të të nxënës pa e larguar kurrikulën nga vëmendja e nxënësit;

- Si mund ta gjurmoj atë që nxënësit mësojnë;
- Si mund të ndihmojnë mjetet digjitale dhe teknologjia ndihmëse në personalizimin e të nxënit.

Larmia e mënyrave të të nxënit, e sukseseve dhe e dështimeve, përvoja e bllokimeve dhe e përparimeve që hasën nxënësit gjatë të nxënit në kushtet e shtëpisë do të jetë e pamundur për t'u mbledhur dhe analizuar nga mësuesit. Gjatë pandemisë nxënësit kanë kuptuar pikat e tyre të forta dhe të dobëta kur bëhet fjalë për të nxënit. Disa mund të kenë zhvilluar strategji të shkëlqyera për të kapërcyer apatinë ose kanë shpikur mënyra të reja të të nxënit që mësuesit nuk mund t'i kishin imagjinuar kurrë. Të gjithë nxënësit do të kenë provuar se çfarë do të thotë të nxësh pa mbështetje. Disa mund të kenë hequr dorë, të tjerët mund të kenë gjetur një mënyrë për të kapërcyer vështirësitë. Ka shumë për të mësuar nga këto përvoja dhe, disa strategji të shpikura nga nxënësit në mungesë të ndihmës, mund të jenë përfituese edhe nga nxënësit e tjerë. Nga ana tjetër, mësuesit kanë provuar se sa e lehtë është të humbasësh gjurmët e mësimit të nxënësve pasi të hiqet siguria e mësimit të së njëjtës përmbajtje për të gjithë nxënësit. Në të njëjtën kohë, pjesa më e madhe e mësuesve janë të vetëdijshëm për faktin se mësimi i njëjtë për të gjithë nxënësit nuk do të thotë se ata të gjithë nxënë njësoj.

Të nxënit është një veprimtari shumë personale dhe nuk gjurmohet lehtë.

Pyetjet e mëposhtme mund të ndihmojnë për të eksploruar çështjet kryesore rreth strategjive për të ndërmarrë një qasje më të individualizuar për të mbështetur të gjithë nxënësit në klasë dhe më gjerë.

Si mund ta bëj të nxënit e nxënësit të dukshëm?

Të nxënit e nxënësve shpesh mbetet i fshehur pas një flete pune që regjistron vetëm numrin e përgjigjeve të sakta ose në klasë ku vetëm nxënësit që e dinë përgjigjen ftohen për ta ndarë atë. Deri në fund të orës së mësimit, nxënësit mund të kenë harruar se cilat përgjigje dhanë dhe pse mësuesi e konsideroi të rëndësishme, të saktë apo të gabuar. Në qoftë se të nxënit nuk bëhet më i dukshëm, nxënësit dhe mësuesit do ta kenë të vështirë të kuptojnë ku duhet të arrijnë në të ardhmen për të ndjekur mënyrat individuale të të nxënit të nxënësve.

Duke i dhënë mundësinë të njohin çfarë do të nxënë kur t'u prezantohet tema e re e mësimit, si mësuesve edhe nxënësve u jepet informacion i rëndësishëm sa për njohuritë e mëparshme edhe për paqartësitë e mundshme që mund të kenë nxënësit. Kur krahasohen paragjykimet me njohuritë e fituara, mënyrat e të nxënit të nxënësve bëhen të dukshme jo vetëm për ta, por edhe për mësuesit dhe prindërit. Hartat e mendjes ose hartat e konceptit vizualizojnë të kuptuarit aktual të nxënësve dhe udhëzojnë mësuesit për të mbështetur nxënësit në të nxënë e tyre. Ndiurma për të kujtuar, etiketat e fjalëve dhe mjetet për të organizuar projektet e nxënësve përgjatë një cikli të zgjidhjes së problemeve, ndihmojnë që të mos humbin detaje dhe të qëndrohet në rrugën e duhur.

Si mund të krijoj mënyra të personalizuar të të nxënit?

Kurrikula është mjeti kryesor i çdo mësuesi për të udhëhequr të nxënit e nxënësve, si dhe punën e tyre. Kurrikula ofron udhëzime për të zhvilluar plane mësimore, për të zhvilluar materiale mësimore dhe për të përgatitur teste. Pjesa më e madhe e mësuesve janë njohur me hartimin e planeve edukative individuale për nxënësit me aftësi të kufizuara. Krijimi i mënyrave të personalizuarra të të nxënit për të gjithë nxënësit me premisën se ata të gjithë do të arrijnë kompetencat e përcaktuara në kurrikul është një ide e re për pjesën më të madhe të mësuesve. Në përgjithësi, pjesa më e madhe e mësuesve besojnë se njohuritë përftohen në një rrjedhë logjike të përcaktuar në kurrikul dhe se nxënësit përparojnë në të nxënë kur mësimdhënia realizohet me metodat më të fundit. Sfidë kryesore në krijimin e mënyrave të personalizuarra të të nxënit është t'u ofrohen nxënësve udhëzime të mjaftueshme dhe jomënyra të fiksuara të të nxënit.

Si mund të përdor mjete digjitale në klasë?

Për pjesën më të madhe që përdorin mjete dhe pajisje digjitale është argëtim dhe të nxënit e "gjërave të mërzitshme" bëhen kënaqësi nëse janë të futura në një lojë. Të nxënit nëpërmjet shikimit të videove ose të dëgjimit të regjistrimeve audio i jep nxënësve mundësinë të përqendrohen në atë çfarë është e rëndësishme për ta dhe të ndjekin mënyra të të nxënit të personalizuarra. Videot që modelojnë aftësitë sociale mund të jenë më efektive sesa mësuesit që u tregojnë nxënësve se çfarë duhet të bëjnë. Realizimi i fotografive ose i videove përmes kamerave të smartphone-ve mund të përdoret për ta bërë të nxënit më të dukshëm dhe për të shkëmbyer informacione me nxënës dhe prindër të tjerë. Nxënësit mund të bëjnë librat, prezantimet ose portofolat e tyre duke përdorur programe kompjuterike për t'u aksesuar në internet. Materialet dhe libraritë mësimore online u japin nxënësve akses të palimituar në njohuri.

Si mund të përdor teknologji ndihmëse në klasë?

Teknologjia ndihmëse është bërë më e përballueshme dhe e arritshme me rritjen e digjitalizimit të shkollave dhe detyrimeve ligjore ndaj prodhuesve të kompjuterave dhe programeve kompjuterike për t'i bërë produktet e tyre të aksesueshme për të gjithë. Përfaqësimet elektronike të materialeve mësimore u mundësojnë nxënësve me shikim të ulët ose atyre me aftësi të kufizuara mësimore ose fizike të konvertojnë materialet në formate alternative të aksesueshme. Duke përdorur gjuhë të lehtë, fëmijët që kanë vështirësi me leximin ose kuptimin e gjuhës janë të fuqizuar të marrin njohuri dhe koncepte pa qenë në disavantazh me të tjerët. Programi kompjuterik që i ndihmon nxënësit të korrigjojnë drejtshkrimin dhe gabimet gramatikore, u lejon të përqendrohen në përmbajtje në vend që të shmangin gabimet gjatë të shkruarit.

Si mund të përdor vetëvlerësimin si strategji për të nxënit?

Vetëvlerësimi ndihmon në drejtimin e nxënësve në mënyrat e tyre të të nxënit. Mund të kombinohet me reagime nga kolegët, veçanërisht kur fëmijët nxënë në mjedise bashkëpunuese. Vetëvlerësimi është një mjet i fuqishëm mësimor, si dhe një përbërës

i rëndësishëm i vlerësimit të nxënësve. Mund të përdoret për të identifikuar boshllëqet e të nxënësve, për ndjekjen ecurisë së të nxënësve, për marrjen e vendimeve mbi metodat dhe strategjitë e të mësuarit, për vendosjen e qëllimeve realiste dhe të arritshme dhe për të qëndruar të përfshirë dhe të motivuar. Vetëvlerësimi nxit vetëreflektimin dhe përgjegjësinë personale për të nxënësit e dikujt. Vetëvlerësimi duhet të marrë të dhëna nga tregues të besueshëm dhe të vlefshëm të kompetencave që synojnë të përmbushen nga nxënësit dhe mësuesit. Këto kritere mund të zhvillohen në mënyrë bashkëpunuese ndërmjet mësuesve dhe nxënësve në fillimin e një periudhe mësimore. Mësuesit mund të hartojnë formate për reflektim të bazuara në këto kritere, në mënyrë që nxënësit t'i përdorin në faza të ndryshme të të nxënësve.